

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XX, nr. 5982  
E mërkurë, 22 janar 2020  
çmimi 0.40 €

Trumpi e quan fitore  
marrëveshjen për linjën  
ajrore Prishtinë - Beograd

FAQE 7



FLET PËR "EPOKËN E RE", MILAZIM KRASNIQI | FAQE 4-5

## KURTI NUK KA OPSION TJETËR PËRPOS QË T'I JAPË LDK-së ATO QË KËRKON



Profesori universitar dhe njohësi i çështjeve politike, Milazim Krasniqi, ka thënë se Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk kanë asnjë opion tjetër përpos që t'i japin Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ato që i kërkon ose ta humbin shansin që Kurti të bëhet kryeministër. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se Kurti është në duart e Isa Mustafës dhe të LDK-së. Ai nuk e përjashton mundësinë e

ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar, sidomos të ShBA-së, për të ndihmuar në formimin e institucioneve të reja. Krasniqi thotë se detyrë e presidentit të vendit është të gjejë mundësi që Kosova të mos shkojë në zgjedhje të reja, që janë të panevojshme. Ai ka theksuar se ka mundësi të formohet një qeveri edhe pa LV-në, por për këtë duhet që edhe LDK-ja t'i heqë vijat e kuqe naive që i ka vendosur pa pikë logjike politike

## Rama dhe Ramushi



NGA BEDRI ISLAMI

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

### OPINION

FLUKSI I FUSHËS  
MAGNETIKE NË PJSËN  
ANËSORE F. 11

Shkruan: Naim  
KRASNIQI, fizikan



### AKTUALE

NJË TËRMET ME MAGNITUDË  
2.8 SHKALLË TË RITERIT GODITI  
TË MARTËN PRIZRENIN F. 6

QKSUK-ja OFROI MBI 204 MIJË  
SHËRBIME STOMATOLOGJIKE  
PËR PACIENTË NË 2019-n F. 7



### EKONOMI



ODAT EKONOMIKE  
PËRSHËNDESNIN INICIATIVËN  
PËR LINJËN AJRORE  
PRISHTINË - BEOGRAD F. 9

FMN-ja VLERËSON  
PUNËN E ATK-SË F. 8

### SPORT

KLUBET E KOSOVËS  
MBUSHIN 'BATERITË'  
NË SHQIPËRI DHE TURQI F. 9

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
  
[www.kolegijbiznesi.com](http://www.kolegijbiznesi.com)  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666



# Rama dhe Ramushi



**Nga Bedri ISLAMI**

Tashmë dihet nga të gjithë, se kryeministri i shtetit shqiptar, Rama, ka hedhur në gjyq, akuzuar për shpifje, shefin në largim të Qeverisë së Kosovës, zotin Haradinaj. Një gjë e tillë ndodh për herë të parë dhe as që ishte menduar më herët se do të mund të ndodhte. Përplasja mes dy njerëzve, që deri para pak muajve shtrëngonin duart mbi flamur dhe besatonin me njëri-tjetrin, në mos qoftë e pazakontë, të paktën është komike.

Sipas akuzës së shefit të qeverisë shqiptare, Rama, gjithçka që ka lindur në konfliktin mes tyre ka të bëjë me deklaratat e mikut të tij të dikurshëm lidhur me lëvizjen e kufijve, ku njëri, Haradinaj, mburret se ishte ai dhe vetëm ai që e shpëtoi Kosovën, pikërisht nga Rama dhe Thaçi, të cilët, gjithnjë sipas shefit në largim të Qeverisë së Kosovës, ishin bërë gati të nënshkruanin një akt tradhtie, ndërse tjetri, Rama, deklaroi se e gjithë kjo është, thjesht, një shpifje që duhet dënuar. Miku i tij në Prishtinë, presidenti i Kosovës, si duket nuk ia vënë veshin kësaj akuze, ndoshta nga që shpeshherë është akuzuar për këtë "lloj tradhtie", saqë e di se asgjë nuk ka vlerë.

A ka të drejtë në akuzën e tij shefi i Qeverisë së Kosovës? Me siguri që jo. Edhe ai vetë e di se e gjithë kjo akuzë, më shumë sesa bindje e tij, është rrjedhë e miqësisë të tashme politike, të cilët, duke e ditur sinqeritetin e tij politik, e kanë më të lehtë të sulmojnë rivalin e tyre në Tiranë përmes një figure të njohur të luftës sesa vetë drejtpërsëdrejti, ndoshta ngaqë mëkati i tyre në çështjen kombëtare është i ndjeshëm.

Edi Rama, jo pak herë, nga forca të ndryshme të politikës në Kosovë, është akuzuar për braktisje të çështjes së tyre, edhe kur, në fakt, ai duhej duartrokatur dhe mbështetur. Megjithatë, ai asnjëherë nuk ka ndërmarrë një hap të tillë, butaforie në vetvete dhe i pakuptimtë në zgjidhjen e tij. Si duket, edhe ai akuzën ndaj ish-mikut të vet e bëri më shumë për t'i goditur rivalët e tij, të njohur si mbështetësit e shefit në largim të Qeverisë së Kosovës.

Më shumë se gjithçka, qoftë goditja pa sens e Haradinajt, qoftë akuzat e tashme e Ramës, kanë të bëjnë me atë që ndodh në

Shqipëri, më shumë se atë që ndodh në Prishtinë. Si në një lojë luftërash, dy liderët qeveritarë kanë ndërruar fushat dhe po bëhen gati t'i përvjelin mëngët. Gjithkush të jetë i bindur, asnjëri nuk do të jetë humbës dhe asnjëri nuk do të jetë i fituar.

Përse e akuzoi Haradinaj shefin e qeverisë shqiptare? Përse shefi i qeverisë shqiptare fillon një padi penale ndaj shefit të Qeverisë së Kosovës?

Haradinaj, duan apo nuk duan në Tiranë, ka qenë një ndër drejtuesit më të shquar të luftës në Kosovë dhe, për më tepër, një ndër përgatitësit e saj kryesorë. Pa dyshim, ka qenë më i njohuri ndër të gjithë komandantët e zonave dhe, po ashtu, pa dyshim, në zonën më të vështirë, mbyllja e së cilës do të ishte fatale për të ardhmen. Jo më kot aty u dërguan disa farkistë, sipas një marrëvesh-

përplasjet në një mjegull, ku asgjë nuk është e qartë.

Edi Ramën e kanë akuzuar për tradhti, për braktisje të idesë së kombit, shitje të interesave kombëtare jo pak herë edhe liderët e opozitës. Edhe tani, në diskutet e tyre të fundit, ata e bëjnë këtë. E bëjnë më me pasion sesa e bëri Haradinaj, i cili ra në një lojë naive të politikës së Tiranës dhe u fut në një rrjedhë që nuk e kishte menduar.

Rama, si shef i qeverisë, ka dërguar në gjyqet e Tiranës rivalët e tij opozitarë, e ka bërë këtë me zell, me pasion, me dëshirë të madhe dhe kjo është e drejta e tij. Por i ka dërguar për shpifje të vogla, gjithnjë sipas perceptimit të saj dhe asnjëherë nuk i ka dërguar për atë që është më thelbësore në jetën e një njeriu të politikës, besnikërinë ndaj kombit. Megjithëse është e ditur se ata që

fillon e humbet rolin e saj afirmues, nxitës dhe krijuese e urave dhe vizioneve të përbashkëta. Ajo nga kujdesi për të mos qenë paternaliste është kthyer në refuzuese dhe larguese; në politikën e saj kanë zënë vend shpërthimet e rastit politik, si është i quajtur "minishengen" që, në fakt, nëse do të vazhdojë me këtë platformë dhe këta aktorë, do të jetë në dem të së përbashkëtës dhe do ta humbë qëllimin që mund të jetë në koka të veçanta.

Jo një herë, nisur nga një mendësi zotëruese, por e panevojshme, ai, shefi i qeverisë shqiptare, nuk e ka menduar pasojën e veprimt të vet dhe, i bindur se vetëm e vërteta e tij është e drejtë, ka shkuar në të kundërtën e asaj që kanë shkuar rivalët e tij; nga paternalizmi në mënjanim; nga ideja e bashkëpunimit në krijimin e dy domeneve politike që nuk kanë

mohimin e saj.

Nëse Berisha e përdori embargon ndërkombëtare për ta bërë tregtinë e zezë të karburanteve dhe armëve, dhe ky është akti më i rëndë politik në jetën e tij, Rama nuk duhet të shkojë në krahun tjetër: t'u hapë të gjitha dyert prodhimeve të skaduara serbe, të cilat dëmtojnë jo vetëm ekonominë shqiptare dhe biznesin shqiptar, por edhe shëndetin njerëzor. Të jesh në gjyq me njeriun tënd, që deri para kohe e quajje vëlla dhe, nga ana tjetër, të përqafohesh dhe të bësh kauzë të përbashkët me ata që deri dje i kanë vrarë njerëzit tuaj e ende nuk kërkojnë faljen e parë, edhe kjo nuk është kombëtare.

Një tryezë e përbashkët "minishengeniste", ende e pasqaruar si duhet, e dyshimtë dhe përjashtuese, po ashtu, nuk është në dobi të shqiptarëve.

Shefi i qeverisë shqiptare dhe shefi në largim i Qeverisë së Kosovës, para se të hedhin bomba ndaj njëri-tjetrit, le ta lexojnë verdiktin e popullit, që në një masë të madhe është për bashkimin e kombit, si aspiratë, si mundësi dhe si kërkesë.

Për to, e jo vetëm për këto që qeverisin sot, më mirë është të jesh i pari në katund sesa i dyti në qytet... pasi, qoftë fshatin këndeje qoftë fshatin andej, i konsiderojnë si domenet e pasurisë së tyre.

Nëse është i vërtetë fakti se rruga e Kosovës drejt BE-së duhet të kalojë përmes shtetit shqiptar, po aq e vërtetë është edhe se rruga e Shqipërisë drejt krijimit të raporteve të reja me shtetin serb duhet, domosdo, të kalojë edhe përmes Prishtinës.

Fakti që Albin Kurti bën gabimin e tij historik politik, duke krijuar rreth bashkues me kundërshtarët e Ramës, si kundërvëniet e miqësisë së këtij të fundit me presidentin e Kosovës, nuk duhet gjetur si alibi për të krijuar edhe më tej vijën ndarëse dhe, për ta bërë atë sa më të dukshme dhe të thelluar, të nisë stina e gjyqeve, për gjëra që mund të zgjidhen lehtësisht brenda mureve, edhe ashtu të hekurta, të politikës shqiptare.

Në gjashtë vjetët e fundit janë bërë disa takime mes shtabeve qeveritare Tiranë - Prishtinë, por është e mundur që më shumë kanë kushuar financiarisht këto mbledhje dhe takime, lojëra basketbolli dhe udhëtime sesa ka qenë dobia e tyre.

Fakti që shteti shqiptar ka mbi vete një përvojë shumë më të gjerë sesa shteti i ri i Kosovës nuk e bënte të parin të jetë dominues ndaj të dytës. Aftësia shtetformuese shqiptare është ende në zanafillën e saj dhe kjo është e vlefshme në të dyja anët e kufirit shtetëror, i cili nuk është edhe kufi mentaliteti.



je ende të mjegullt, të cilët synuan pikërisht këtë: largimin e Haradinajt nga drejtimi i Zonës Operative të Dukagjinit dhe vendosjen aty të disfatistëve, të cilët pastaj ia mbathën dhe u bënë pjesë e grushtit të shtetit të shtatorit të vitit 1998. Për qëndrimin e Haradinajt në luftë është e tepërt të flitet. Ai ka qenë një ndër komandantët më të shquar të zonave operative, në mos më i shquari, dhe debati për rolin e tij në luftë nuk ka të bëjë me përplasjen e tashme.

Çfarë mund të synohet të arrihet përmes një gjyqi, i cili, më shumë se një përplasje mes dy shefave, do të jetë një grindje politike e cila jo vetëm nuk do të mund ta qartësojë rrjedhën e ngjarjeve, por edhe nuk do të ketë një përcaktim përfundimtar, pasi vetë shpjegimi i gjërave gjithnjë do të jetë i njëanshëm. Përzierja në këtë përplasje e liderëve të opozitës në Shqipëri, duke u bërë palë me kundërshtarët e Ramës, jo vetëm nuk qartëson gjë, por e bën edhe më të dukshme karrocetën politike të gjithë kësaj përplasje, që frymëzimin e ka në zyrat presidenciale apo opozitare, vazhdon si rrjedhë e asaj që ndodh në Prishtinë dhe

po e akuzojnë për bjerrje të vlerës kombëtare, në të shumtën janë nga ajo mori që nuk i kanë pasur kurrë këto vlera, që janë përafuar në çastet më të rënda të kombit në anën e gabuar. Përse Rama nuk i ka dërguar ato në një gjyq të hapur publik, por e përcjellë zemërimin e tij tej kufijve, kjo është, po ashtu, e drejta e tij, veçse një e drejtë që shkon ndesh me atë që vetë ka nxitur, bashkësinë jetuese.

Në raportet me Kosovën Edi Rama ka pasur çastet e tij shkëlqyese, ashtu si edhe ato humbëse; ka pasur ditët e tij të zenitit, por edhe të rënies. E vërteta është se në raportet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, e majta ka pasur gjithnjë një horizont më të gjerë, më reflektues, ka qenë më e hapur dhe ka nxitur gjithnjë krijimin e urave të përbashkëta, edhe kur ato nuk janë prituri dhe janë cilësuar, ose të parakohshme, ose jo të drejta; ndryshe nga rivalët e tyre në Shqipëri, e majta e dikurshme nuk ishte kurrë në idenë paternaliste ndaj politikës në Kosovë dhe nuk luajti kurrë me ndjenjën e pushtetit.

Tani ndodh ndryshe: për herë të parë, e majta, përmes Rilindjes,

lidhje njëri me tjetrin; nga krijimi i raporteve të njëmendta dhe të njënjëshme me të gjithë faktorët politikë në Kosovë, në përzgjedhjen e tyre; nga politika pragmatiste e përbashkësie në krijimin e një ndarje vizionesh, sikur të ishte fjala për dy qasje të ndryshme.

Megjithëse është e drejta e tij t'i përzgjedhë këshilltarët e ministrit, njerëzit me të cilët rrethohet dhe që krijojnë stafin e tij të gjerë apo të ngushtë, qofshin nga Kosova apo viset e tjera shqiptare, shefi i qeverisë shqiptare kurdoherë nuk mund ta shkëpusë përzgjedhjen e tij nga ajo që do të vlerësohet nga njerëzit. Si edhe pararendësit e tij kryeqeveritarë, edhe për Ramën ka qenë më e lehtë të mbledhë rreth vetes figura, të cilat, për vetë të shkuarën e tyre, disa herë haptas në dobi të shërbimit të fshehtë serb apo paraardhësit e tyre të kenë qenë funksionarë të lartë të regjimit shtypës në Kosovë dhe kjo ka krijuar një zbrazëti rreth tij dhe figurës së tij.

Nëse Berisha e konceptonte Prishtinën si domenin e vet, që mund ta përdorte për lojërat e rënda politike, Rama nuk mund të shkojë në të kundërtën, në



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur të martën mbledhjen e Kryesisë, në të cilën ka diskutuar për mundësinë e një marrëveshje për bashkëqeverisje me Lëvizjen Vetëvendosje

# LDK-ja nuk tërhiqet nga oferta, përsëritë marrëveshje të balancuar me LV-në

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka ftuar Lëvizjen Vetëvendosje (LV) të veprojë shpejt dhe me vendosmëri për ta arritur marrëveshjen për bashkëqeverisje. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë se marrëveshja me LV-në duhet të jetë e balancuar. "Marrëveshja duhet ta vë në pah një qeveri të balancuar me përgjegjësi të balancuar ndërmjet dy palëve në harmoni me atë që qytetarët e Kosovës na kanë dhënë besimin me votën e tyre", ka thënë Mustafa, duke shtuar se brenda kësaj jave duhet të konstatohet nëse kjo marrëveshje mund të arrihet



LDK-ja fton Lëvizjen Vetëvendosje, si parti e parë dhe që ka përgjegjësinë për t'i formuar institucionet e reja, të veprojë shpejt dhe me vendosmëri për të arritur marrëveshje të përbashkët për formimin e institucioneve të reja. Pas mbledhjes së Kryesisë, në një deklaratë për medie LDK-ja ka vlerësuar se kjo parti shpreh vullnetin për marrëveshje politike të balancuar me Lëvizjen Vetëvendosje, që do ta reflektonte në tërësi rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit. "LDK-ja vlerëson që vendi ndodhet në një situatë të rëndësishme politike meqë tashmë implementimi i vullnetit politik të qytetarëve, shprehur në zgjedhjet e 6 tetorit 2019, në bazë të dispozitave kushtetuese, është i afatizuar. LDK-ja edhe një herë shpreh vullnetin për marrëveshje politike të balancuar me Lëvizjen Vetëvendosje, që do ta reflektonte në tërësi rezultatin e zgjedhjeve të 6 tetorit", është thënë në deklaratën e LDK-së, e cila ka ftuar LV-në që të reflektojë në bisedime. "Kryesia e LDK-së konsideron që marrëveshja e propozuar nga ekipi negociues i LDK-së, e mbështetur në orientimet e Këshillit të Përgjithshëm, e reflekton në tërësi rezultatin e zgjedhjeve, garanton përfaqësim dhe përgjegjësi të balancuar, që janë të domosdoshme për funksionimin e institucioneve dhe për demokracinë në vend. LDK-ja fton Lëvizjen Vetëvendosje, si parti e parë dhe që ka përgjegjësinë për t'i formuar institucionet e reja, që të veprojë shpejt dhe me vendosmëri për ta arritur marrëveshjen me LDK-në", është thënë në deklaratën e Kryesisë së LDK-së. Këtë deklaratë e ka përkrahur edhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa. Ai ka thënë se kjo parti mbetet e përkushtuar për marrëveshje me

LV-në. "Ne mbetemi të përkushtuar që të punojmë për marrëveshje, mirëpo për një marrëveshje e cila, siç u tha në deklaratë, respekton vullnetin e qytetarëve tanë në zgjedhjet e 6 tetorit të vitit të kaluar. Marrëveshja duhet ta vë në pah një qeveri të balancuar me përgjegjësi të balancuar ndërmjet dy palëve në harmoni me atë që qytetarët e Kosovës na kanë dhënë besimin me votën e tyre", ka thënë Mustafa, duke shtuar se brenda kësaj jave duhet të konstatohet nëse kjo marrëveshje mund të arrihet. "Ne kemi dhënë një propozim që kemi vlerësuar se është propozim i balancuar, që mendoj se LV-ja duhet ta trajtojë me vëmendje të veçantë dhe me besim të hapur të ulemi e të bisedojmë, por që ajo bisedë të ketë një përfundim sa më të shpejtë, mundësisht deri në fund

të kësaj jave, në mënyrë që ta bëjmë marrëveshje ose të konstatojmë se nuk ka kushte që marrëveshja të bëhet. Prandaj, ne mbesim në këto pozita, por gjithsesi me vullnet që të përfundojmë një marrëveshje e cila është në dobi të qytetarëve", ka thënë Mustafa. Në ditën e nominimit për kryeministër Albin Kurti e ka ftuar LDK-në që t'u kthehet takimeve për ta arritur marrëveshjen. Pas propozimit të Albin Kurtit si mandatar për kryeministër të ri të Kosovës nga Lëvizja Vetëvendosje dhe dekretimit të këtij propozimi nga presidenti i vendit, Hashim Thaçi, të cilin ky i fundit e ka dërguar në Kuvendin e Kosovës, të hënën ka nisur rrjedhja e afatit të parë ligjor prej 15 ditësh për krijimin e qeverisë së re të vendit. Nëse lideri i LV-së brenda 15

ditësh nuk mund ta formojë qeverinë e re mbetet në diskrecionin e presidentit të vendit, Hashim Thaçi, se kush do të jetë mandatar i dytë për formimin e qeverisë së re. Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës i kanë nisur negociatat për krijimin e një koalicioni qeverisës menjëherë pas zgjedhjeve të 6 tetorit ndërkaq, pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 27 nëntor, ato nisën punën për harmonizimin e programit qeverisës. Megjithatë, për shkak të mospajtimeve të caktuara, ato ende nuk kanë arritur një marrëveshje, ndërkaq që negociatat, tash për tash, janë ndërprerë dhe ende nuk ka ndonjë paralajmërim që mund të ketë ndonjë nismë për vazhdimin e tyre.

## Haradinaj priti në takim lamtumirës komandantin e karabinierëve italianë

PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka pritur të martën në takim lamtumirës, komandantin e Njësisë së Specializuar Multinacionale (MSU) në kuadër të KFOR-it, kolonel Paolo Pelosi, të cilin e ka falënderuar për punën dhe kontributin e deritanishëm në Kosovë, për forcimin e sigurisë, të rendit dhe ligjit në Kosovë. Ai ka thënë se Njësia e Karabinierëve italianë ka bërë punë të shkëlqyer në Kosovë dhe në bashkëpunim të mirë me institucionet e Kosovës kanë ofruar siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës. "Roli juaj dhe i karabinierëve për ruajtjen e

qetësisë, rendit dhe krijimin e një klime të sigurisë është i një rëndësie të veçantë dhe për këtë ju jemi mirënjohës", është shprehur Haradinaj, duke vlerësuar se Italia ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të veçantë edhe përmes trupave paqeruajtëse që veprojnë në kuadër të KFOR-it.

Ndërsa komandanti i Njësisë së Specializuar Multinacionale (MSU), kolonel Paolo Pelosi, pasi shprehu falënderimin për bashkëpunimin me institucionet e Kosovës, tha se kjo njësi do ta vazhdojë angazhimin e saj për paqen dhe sigurinë e të gjithë qytetarëve të Kosovës.





Flet për "Epokën e re", Milazim Krasniqi

# Kurti nuk ka opsion tjetër përpos



Profesori universitar dhe njohësi i çështjeve politike, Milazim Krasniqi, ka thënë se Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje nuk kanë asnjë opsion tjetër përpos që t'i japin Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ato që i kërkon ose ta humbin shansin që Kurti të bëhet kryeministër. Në intervistën dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se Kurti është në duart e Isa Mustafës dhe të LDK-së. Ai nuk e përjashton mundësinë e ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar, sidomos të ShBA-së, për të ndihmuar në formimin e institucioneve të reja. Krasniqi thotë se detyrë e presidentit të vendit është të gjejë mundësi që Kosova të mos shkojë në zgjedhje të reja, që janë të panevojshme. Ai ka theksuar se ka mundësi të formohet një qeveri edhe pa LV-në, por për këtë duhet që edhe LDK-ja t'i heqë vijat e kuqe naive që i ka vendosur pa pikë logjike politike

Meqë në mars mbyllet qeveria, atëherë është e qartë se bllokohet i tërë sektori publik, por në atë rast bie edhe konsumi, pra dëmtohet rëndë edhe sektori privat. Përtej kësaj mund të ketë trazira sociale, të cilat, në një vend që nuk ka qeveri efektive, zor se mund të kontrollohen", ka deklaruar Krasniqi.

**"Epoka e re":** Z. Krasniqi, tashmë presidenti ka dekretuar liderin e Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër të ardhshëm. A besoni se brenda këtij 15 ditëshi z. Kurti do të mund të arrijë një marrëveshje me LDK-në për ta formuar qeverinë?

**Krasniqi:** Përgjigja është e vështirë ngaqë lëvizjet e deritashme politike të Albin Kurtit dhe të partisë së tij nuk janë krejtësisht racionale. Loja e tij politike në drejtim të Lidhjes Demokratike të Kosovës është një kombinim i presioneve, luftës speciale, propagandës dhe tentimit që të përçahet e të vihet para aktit të kryer. Në fillim ishte një shpërthim triumfalizmi, në të cilin arriti ta tërhiqte edhe Vjosa Osmanin, me të cilin e shpalli si

**EPOKA E RE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 21 JANAR** - Profesori universitar dhe njohësi i çështjeve politike, Milazim Krasniqi, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" ka folur për përpjekjet që po bëjnë Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) për arritjen e një marrëveshje për ta formuar qeverinë. Ai thotë se Albin Kurti është në duart e Isa Mustafës dhe të LDK-së. Krasniqi ka thënë se lëvizjet e deritashme politike të Albin Kurtit dhe të partisë së tij nuk janë krejtësisht racionale. "Ndërsa tash

që Albin Kurti është dekretuar si mandatar, hapësira për lojëra dhe presione i është kufizuar. Tash ai vetë është nën presion. Nëse LDK-ja nuk i përgjigjet pozitivisht, ai thjesht nuk mund të bëhet kryeministër. Kjo i bie saktë ashtu siç pati deklaruar Lutfi Haziri, që kandidatura e Kurtit kalon nëpër zyrat e LDK-së", ka thënë Krasniqi, duke shtuar se Kurti dhe LV-ja tashmë nuk kanë asnjë opsion tjetër përpos që t'i japin LDK-së ato që i kërkon, ose ta humbin shansin që Kurti të bëhet kryeministër.

Profesori Krasniqi ka thënë se detyra e presidentit Hashim Thaçi është të gjejë mundësi që vendi të

mos shkojë në zgjedhje të panevojshme, të cilat jo vetëm se kushtojnë shumë para, por edhe humbasin shumë kohë. "Pra, unë konsideroj se ka mundësi të formohet një qeveri edhe pa Kurtin e pa LV-në, por për këtë duhet që edhe LDK-ja t'i heqë vijat e kuqe naive që i ka vendosur pa pikë logjike politike", është shprehur ai. Krasniqi nuk e përjashton mundësinë e ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar, sidomos të ShBA-së, për të ndihmuar në formimin e institucioneve të reja. "Më së miri do të ishte të arriheshin marrëveshjet pa ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar. Kjo do të shënonte njëfarë pjekurie të elitës

sonë politike. Por, nëse nuk e kanë arritur atë pjekuri, më mirë është të na ndihmojnë ndërkombëtarët sesa të përfundojmë në kolaps dhe në anarki. Por cilët ndërkombëtarë? Personalisht mendoj se mund të ndihmojë vetëm administrata e ShBA-së, e cila është sponsorja jonë dhe vetëm ajo e ka një qartësi strategjike lidhur me Kosovën. Jo 'Soros' e kampanja të ngjashme me të, të cilët kanë projekte okulte ndaj Kosovës e shqiptarëve", është shprehur ai. Në rast se nuk do të ketë formim të qeverisë së re, Krasniqi parashihet trazira sociale. "Rreziku nga futja në kolaps tashmë është evident.



# që t'i japë LDK-së ato që kërkon



fakt të kryer bashkëqeverisjen, pa i marrë fare leje LDK-së. Pasi kjo nuk u realizua lehtë e shpejtë, LV-ja e filloi terrorin psikologjik, në rrjete sociale e media të tjera, kundër figurave kryesore të LDK-së, Isa Mustafës, Lutfi Hazirit e Agim Veliut. Denigrimi kishte elemente të gjuhës së urrejtjes, bullizmit dhe të thirrjes për linçim. Pastaj komunikimi arbitrar eskaloj e një komunikim arrogant e të panatyrshëm të Kurtit me anën e video-mesazheve, të cilat kishin elemente të propagandës në favor të LV-së dhe të luftës speciale kundër LDK-së. Me këto taktika ai e ka përkeqësuar raportin me LDK-në deri në atë masë sa e ka shkrirë tërësisht entuziazmin naiv fillestar që ekzistonte te shumë njerëz në LDK, për koalicion me LV-në. Në këtë kuadër, LV-ja e ka dëmtuar rëndë edhe pozitën e Vjosa Osmanit, të cilën tentuan ta paraqesin si kukull të LV-së, madje duke propozuar që ajo të caktohej nga LDK-ja si kandidate për presidente. Ideja se mund t'ia caktosh një partie tjetër kuadrot për pozitat shtetërore është e padëgjuar në botën normale! Ndërsa tash që Albin Kurti është dekretuar si mandatar, hapësira për lojërë dhe presione i është kufizuar. Tash ai vetë është nën presion. Nëse LDK-ja nuk i përgjigjet pozitivisht, ai thjesht nuk mund të bëhet kryeministër. Kjo i bie saktë ashtu siç pati deklaruar Lutfi Haziri, që kandidatura e Kurtit kalon nëpër zyrat e LDK-së. Meqë nuk ka opsion tjetër përveç koalicionit me LDK-në për shkak të vijave të kuqe që i ka vendosur irracionalisht, Kurti dhe LV-ja tashmë nuk kanë asnjë

opsion tjetër përpos që t'i japin LDK-së ato që i kërkon, ose ta humbin shansin që Kurti të bëhet kryeministër. Definitivisht, Kurti është në duart e Isa Mustafës dhe të LDK-së. Këtu ka ardhur me gabimet e veta, jo nga ndonjë taktikë tinëzare e LDK-së. Pra, nëse formohet qeveria, ajo do të ishte meritë e LDK-së, jo e Kurtit. Esencialisht, Kurti ka punuar kundër kandidaturës dhe zgjedhjes së vet për kryeministër. Prandaj, veprimet e tij nuk më duken krejt racionale dhe, si të atilla, nuk mund të parashikohen.

**"Epoka e re":** Nëse LDK-ja refuzon bashkëpunimin me LV-në, a ka opsion tjetër që shmang zgjedhjet e reja?

**Krasniqi:** Në atë rast presidenti duhet të kërkojë një kandidat që mund t'i sigurojë firmat e 61 deputetëve dhe ta dekretojë si mandatar të ri. Detyra e presidentit është të gjejë mundësi që vendi të mos shkojë në zgjedhje të panevojshme, të cilat jo vetëm se kushtojnë shumë para, por edhe humbasin shumë kohë. Vendi tash sa muaj nuk ka qeveri efektive dhe nëse kjo vazhdon edhe disa muaj, vendi mund të kollopsojë. Kjo nuk do të duhej të lejohej për kapricet e askujt. Pra, unë konsideroj se ka mundësi të formohet një qeveri edhe pa Kurtin e pa LV-në, por për këtë duhet që edhe LDK-ja t'i heqë vijat e kuqe naive që i ka vendosur pa pikë logjike politike. Nuk ka logjikë dhe as moral të qeverisë me Listën Serpska, ndërsa të shpallen ilegjitime parti si PDK-ja, AAK-ja e Nisma. Atyre mund t'u bëhen kërkesa eksplicite, fjala

vjen, lidhur me taksën, dialogun me Serbinë, luftën kundër korrupsionit, por nuk mund të shpallen ilegjitime. Ky ka qenë dhe është budallallëk, sepse kështu LDK-ja dhe LV-ja kanë bllokuar veten, po rrezikojnë ta bllokojnë edhe shtetin. Pra, nëse eliminohen vijat e kuqe, ka më shumë opsione për formimin e qeverisë së re. Por, një qeveri pa Kurtin e pa LV-në duhet të llogaritet në trazira të dhunshme, të cilat mund ta kollopsojnë shtetin dhe, ndoshta, edhe ta shpërbëjnë. Ky shtet është shumë i brishtë, i papërfuduar si projekt, i ekspozuar brutalisht ndaj projekteve armiqësore, për ç'arsye të gjithë aktorët politikë do të duhej të kishin kujdes dhe të mos ndërmermin veprime dëmtuese. Nëse ndërmarrin, mund të bëhen përgjegjës për kollapsimin e shtetit, në versionin më tragjik edhe për zhbërjen e tij.

**"Epoka e re":** Sa ka rrezik që Kosova të hyjë në krizë të thellë politike, sepse është e qartë që tre muaj jemi në bllokadë politike?

**Krasniqi:** Rreziku nga futja në kolaps tashmë është evident. Meqë në mars mbyllet qeveria, atëherë është e qartë se bllokohet i tërë sektori publik, por në atë rast bie edhe konsumi, pra dëmtohet rëndë edhe sektori privat. Përtej kësaj mund të ketë trazira sociale, të cilat, në një vend që nuk ka qeveri efektive, zor mund të kontrollohen. Pra, në versionin më të keq, shteti mund të shpërbëhet, pikërisht ashtu siç edhe janë projeksionet e armiqve të Kosovës. Unë besoj se politikanët e lartë të vendit tonë këtë gjë e dinë më mirë se unë. Prandaj, prej

tyre pritet që të jenë më të kujdesshëm.

**"Epoka e re":** A mendoni se angazhimi i faktorit ndërkombëtar do të mund t'i jepte shtytje formimit të institucioneve?

**Krasniqi:** Më së miri do të ishte të arriheshin marrëveshjet pa ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar. Kjo do të shënonte njëfarë pjekurie të elitës sonë politike. Por, nëse nuk e kanë arritur atë pjekuri, më mirë është të na ndihmojnë ndërkombëtarët sesa të përfundojmë në kolaps dhe në anarki. Por cilët ndërkombëtarë? Personalisht mendoj se mund të ndihmojë vetëm administrata e ShBA-së, e cila është sponsorja jonë dhe vetëm ajo e kanë një qartësi strategjike lidhur me Kosovën. Jo 'Soros' e kampanja të ngjashme me të, të cilat kanë projekte okulte ndaj Kosovës dhe shqiptarëve.

**"Epoka e re":** Kush fiton e kush humbet nëse vendi shkon në zgjedhje të reja?

**Krasniqi:** Nëse vendi shkon në zgjedhje humbet Kosova dhe qytetarët e saj. Në atë rast do të harxhoheshin shumë para e shumë energji, do të ashpërsohej lufta partiake, do të dobësohej kohezioni social. Thënë thjesht, do të mund të dështonte shteti. Ndërsa fitues do të ishin vetëm armiqtë e Kosovës, ata që thonë se shqiptarët nuk janë të aftë të vetëqeverisen dhe ata që kanë plane për të zhvatur e shkërryer pasuritë nëntokësore të Kosovës, nëse Kosova bëhet shtet i dështuar. Ata, si duket, po e nxisin bllokimin politik dhe ata po presin dështimin, që të kalojnë në aksion final - zhbërës e shkërryes.

## Konjufca dhe ambasadorja kroate flasin për forcimin e miqësisë Kosovë - Kroaci


**PRISHTINË, 21 JANAR (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur të martën në takim ambasadorën e Kroacisë në vendin tonë, Danijela Barisiq, me të cilën ka biseduar për zhvillimet në vend dhe rajon, për bashkëpunimin midis dy shteteve mike dhe për mundësitë e zgjerimit të mëtejshëm të tij.

Konjufca vlerësoi lart marrëdhëniet politike dhe diplomatike midis Kosovës dhe Kroacisë, duke konsideruar se ka ende hapësira për rritjen dhe zgjerimin e këtij bashkëpunimi në fusha të ndryshme, të cilat duhet të shfrytëzohen në të ardhmen.

Kreu i Kuvendit e konsideroi të rëndësishme përvojën parlamentare kroate, sidomos atë të integritetit evropian, të cilat, siç

ka thënë ai, mund t'i shërbejnë Kosovës si model në procesin e integritetit euro-atlantik dhe forcimin e mëtejshëm të demokracisë parlamentare. Konjufca theksoi nevojën që Kroacia të vazhdojë të jetë përkrahëse e Kosovës në institucioneve ndërkombëtare në të cilat vendi ynë aspiron të anëtarësohet.

Ambasadorja kroate, Barisiq, pasi uroi kryetarin Konjufca për detyrën e re, shprehu gatishmërinë e shtetit të saj për t'i ofruar Kosovës përvojën në rrugën e integritetit, duke garantuar mbështetjen e Zagrebit zyrtar për Prishtinën në të gjithë mekanizmat relevantë ndërkombëtarë. Ajo e informoi kryetarin Konjufca për përparësitë e presidencës së Këshillit të BE-së nga Kroacia.



"Nën moton 'Një Evropë e fortë në një botë sfiduese', Kroacia do të trajtojë katër përparësi: një Evropë në zhvillim, një Evropë që lidh, një Evropë që mbron dhe një Evropë me

ndikim", ka deklaruar Barisiq. Diplomata kroate ka thënë se Kroacia do të organizojë një samit të vendeve anëtare të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor në Zagreb në maj të këtij viti, duke

shprehur besimin se samiti do të ishte një shtytje për vazhdimin e procesit të zgjerimit dhe perspektivën evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor.



# Në 14-vjetorin e vdekjes përkujtohet ish-presidenti Rugova

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 JANAR - Me rastin e 14-vjetorit të vdekjes së ish-presidentit të Kosovës, Ibrahim Rugova, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka mbajtur akademi përkujtimore. Nën intonimin e flamurit ka filluar academia përkujtimore në shenjë nderimi dhe përkujtimi për ish-presidentin Ibrahim Rugova. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, ka thënë se Kosova ka humbur njeriun e lirisë dhe pavarësisë. Sipas Mustafës, ish-presidenti Rugova nuk arriti t'i shohë gjërat që i kishte ndërtuar vetë. "Në këtë përvjetor po kujtojmë me nderimet më të larta kryetarin e parë të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe presidentin historik, doktor Ibrahim Rugova. Humbëm njeriun e lirisë dhe idesë së pavarësisë. Presidenti u nda nga kjo jetë dhe nuk arriti ta shihte pullazin e shtëpisë që vetë e kishte ndërtuar", ka thënë Mustafa, duke shtuar se Rugova u bë simbol i paqes dhe i rezistencës. Siç ka thënë ai, Rugova me çdo kusht punoi që Kosova

të bëhet pjesë e Evropës dhe t'i gëzojë këto marrëdhënie që ka me shtetet mike. "Rugova punoi për idenë e pavarësisë. Si prijës ishte i veçantë. Ai kundërshtoi propagandën serbe. U bë simbol i paqes dhe i dashurisë që gjithmonë ishte sunduar nga armë zjarri e terrori. U bë simbol i rezistencës. Me çdo kusht provoi se Kosova i përket Evropës. I krijoj Kosovës shumë miq që patën ndikim, me ShBA-në dhe shtetet e tjera mike", ka thënë Mustafa.

Ndër të tjera, Mustafa ka thënë se LDK-ja është parti edhe tani siç ka qenë në kohën sa ishte gjallë Rugova dhe do të vazhdojë në këtë mënyrë. "Kosova meriton të bëhet vend i zhvilluar ekonomikisht dhe të jetë i dashur për qytetarët e saj. Rugova shkruante për pasuritë tona natyrore, vlera që i japin vulën këtij vendi dhe ia shtojnë identitetin këtij populli. Zoti e bekoftë Ibrahim Rugovën!", u shpreh Mustafa.

Ish-presidentin Rugova e kanë përkujtuar edhe presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj. "Në 14-vjetorin e vdekjes së presidentit Rugova nderojmë kontributin e madh të tij në



rrugëtimin e gjatë dhe të mundimshëm të popullit tonë drejt lirisë dhe pavarësisë. Politika paqësore dhe miqësia me ShBA-në e Perëndimin janë vlera të përhershme të trashëgimisë së presidentit Rugova", ka shkruar Thaçi në

llogarinë e vet në "Facebook". Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj ka bërë homazhe te varri i ish-presidentit Rugova. "Vepra e tij, por edhe vetë ndarja fizike nga ne, mbahet në mend gjithë jetën, sepse ka zgjuar gjithë popullin e

Kosovës, prandaj përjetësisht do të nderohet figura e presidentit Rugova", ka thënë Haradinaj pas homazheve. Ish-presidentin Rugova e kanë përkujtuar edhe lideri i LV-së, Albin Kurti dhe ai i PDK-së, Kadri Veseli.

## KDI-ja interesohet për zbatimin e marrëveshjes së drejtësisë në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi



MITROVICË, 21 JANAR (ER) - Përfaqësues të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) kanë realizuar të martën një takim me kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, Shyqri Sylja. Në këtë takim u diskutua rreth nivelit të zbatimit të marrëveshjes së drejtësisë e arritur në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi nën ndërmjetësimin e BE-së. Temë diskutimi ishte shuarja e strukturave paralele të drejtësisë, integrimi i prokurorëve serbë në sistemin e drejtësisë në Kosovë, performanca e kësaj

prokurorie si dhe sfidat për zbatimin e kësaj marrëveshje të Brukselit.

KDI-ja do të zhvillojë takime me institucionet përkatëse të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjeve të dialogut, me qëllim të rritjes së transparencës rreth këtij procesi.


Ky takim është zhvilluar në kuadër të projektit "Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë" që përkrahët nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë

## Një tërmet me magnitudë 2.8 shkallë të riterit goditi të martën Prizrenin

PRIZREN, 21 JANAR (ER) - Bazuar në Rrjetin Sizmik, Shërbimit Gjeologjik të Kosovës dhe Qendrës Sizmike Euro-Mediterrane, si dhe në analizën numerike të Rrjetit Sizmologjik të Kosovës, të

martën në orën 10:26, sipas kohës lokale, Kosova është goditur nga një tërmet me magnitudë 2.8 sipas shkallës rihter, përkatësisht me intensitet IV ballë të Merkalis. Thellësia hipoqendrore ishte 4

kilometra. Epiqendra e këtij tërmeti ishte 10 kilometra në verilindje të Prizrenit, në lindje të Korishës. Tërmeti në fjalë është ndier dukshëm nga qytetarët e regjionit të Prizrenit.





Nënshkrimi i marrëveshjes për linjën ajrore Prishtinë - Beograd ka nxitur reagime vendore dhe ndërkombëtare

# Trumpi e quan fitore marrëveshjen për linjën ajrore Prishtinë - Beograd



Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, e ka përshëndetur nënshkrimin e marrëveshjes për linjën ajrore Prishtinë - Beograd, duke e quajtur atë një tjetër fitore. Një ditë pas nënshkrimit të saj, edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett, ka vlerësuar se kjo marrëveshje është vetëm fillimi për të ardhmen e shqiptarëve dhe të serbëve

fillimi për të ardhmen e shqiptarëve e të serbëve. "Presidenti Trump dhe ekipi i tij kanë punuar shumë për ta arritur këtë marrëveshje, që është vetëm fillimi i një të ardhme të ndritur për shokët tanë në Kosovë dhe Serbi. Ky hap është një fitore për regjionin. Faleminderit ambasadorit Grenell për leadershipin e tij!", ka shkruar Kosnett.

Marrëveshjen e ka mirëpritur edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ndërsa ka vlerësuar lart ndihmën dhe mbështetjen e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, për Kosovën. "Marrëveshja për vendosjen e linjës së re ajrore dhe përshëndetja e dedikuar që i bëri presidenti Donald Trump janë dëshmi e vëmendjes së vazhdueshme dhe kujdesit të pandalur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ndaj Republikës së Kosovës dhe stabilitetit të rajonit tonë. Ne jemi të nderuar e krenarë që gëzojmë këtë mbështetje amerikane dhe ndihemi se jemi në rrugën e drejtë e të sigurt kurdoherë që është e përfshirë dhe e angazhuar ShBA-ja", ka shkruar Veseli në profilin e vet në "Twitter". Këtë marrëveshje e ka komentuar

edhe analisti amerikan Daniel Serwer, i cili beson se kjo marrëveshje është një shpresë për ripërtëritjen e dialogut. Ai ka vënë në dukje se qytetarët do të përfitojnë më shumë nga prezantimi i linjës ajrore.

Serwer, i cili është ekspert në Ballkan, ka thënë për "Zërin e Amerikës" se kjo marrëveshje është "impuls i ri" dhe duhet t'i tejkalojë rrethanat aktuale politike në Kosovë dhe se Beogradi e Prishtina do të kthehen në tryezën e bisedimeve kur të zgjidhet Qeveria e Kosovës. "Dhe atëherë do të shfaqet një problem i ri - periudha e zgjedhjeve dhe fushata në Serbi. Kjo mund ta ngadalësojë të gjithë përparimin më domethënës në bisedimet mes të dyja palëve. Gjithashtu, dialogu është një proces i ndërmjetësuar nga Evropa, që përfshin herë pas here amerikanët, i sigurt se një ndërveprim i tillë gjithmonë do të japë rezultatet më të mira", ka thënë Serwer, duke shtuar se kjo marrëveshje është nënshkruar pa ndihmën e BE-së. "Nëse shkojmë thellë, mund të konkludojmë se marrëveshja është arritur me ndërmjetësimin ekskluzivisht të ShBA-së dhe pa

evropianët, në konsultim me NATO-n, duket se nuk kishte asnjë formë të përfshirjes së Bashkimit Evropian, apo një veprim të bashkërenduar nga Amerika dhe BE-ja", ka deklaruar Serwer.

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka nënshkruar të hënën në Berlin një marrëveshje me aviokompaninë gjermane "Lufthansa", për ta hapur linjën ajrore Prishtinë - Beograd. Përmes një komunikate për media, Ministria e Infrastrukturrës dhe Transportit ka bërë me dije se kompania "Lufthansa" duhet t'i kërkojë aprovimet dhe licencat për të gjitha fluturimet, sipas kërkesave, rregulloreve dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, sipas marrëveshjes për ECAA (Marrëveshja e Zonës së Aviacionit të Përbashkët Evropian).

Një ditë më parë marrëveshjen e ka përshëndetur edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, dhe kryeministri në detyrë Ramush Haradinaj. Deri më tani këtë marrëveshje nuk e kanë komentuar i nominuari për kryeministër, Albin Kurti dhe lideri i LDK-së, Isa Mustafa.

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 21 JANAR** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, e ka quajtur fitore marrëveshjen për vendosjen e fluturimeve të drejtpërdrejta në mes të Kosovës dhe Serbisë. Përmes një postimi në rrjetin social "Twitter", ai ka shkruar se të gjithë thoshin se kjo marrëveshje nuk bëhet. "Të gjithë thoshin se nuk bëhet dot. Por, për herë të parë në një gjeneratë do të ketë fluturime të drejtpërdrejta midis Serbisë dhe Kosovës. Një tjetër fitore", ka shkruar Trump. Për këtë të arritur ai ka falën-

deruar ambasadorin e ShBA-së në Berlin, Richard Grenell, si dhe këshilltarin e tij për Siguri Kombëtare, Robert O'Brien. Ndërsa Këshilli Amerikan i Sigurisë Kombëtare, në faqen zyrtare në "Twitter" e ka vlerësuar marrëveshjen historike. "Ditë historike. Po kapërcejmë të kaluarën duke ndërtuar përpara një marrëdhënie normale midis fqinjëve", është shkruar Këshilli Amerikan i Sigurisë Kombëtare.

Një ditë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje ka reaguar edhe ambasadori amerikan në Prishtinë, Philip Kosnett. Përmes një postimi në "Twitter", Kosnett ka vlerësuar se kjo marrëveshje është vetëm

## QKSUK-ja ofroi mbi 204 mijë shërbime stomatologjike për pacientë në 2019-n

**PRISHTINË, 21 JANAR (ER)** - Në Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës gjatë vitit 2019 janë ofruar më shumë se 204 896 shërbime për pacientët të cilët kishin nevojë për intervenime rreth problemeve të ndryshme stomatologjike.

Sipas raportit të punës, në periudhën njëvjeçare të aktiviteteve shëndetësore në QKSUK janë regjistruar 57 mijë e 209 vizita kontrolluese dhe 6 mijë e 652 sosh për herë të parë. Në të dhënat zyrtare, për 12-mujorin e vitit të shkuar jashtë

Prishtinës figurojnë rreth 97 530 aktivitete, duke përfshirë këtu shërbime stomatologjike dhe vizita nga pacientët. Në klinikat e QKSUK-së, të cilat kanë performuar me kapacitet të plotë, gjatë kësaj kohe janë ofruar mbi 14 040 shërbime.





# DUKURIA E FAJDEVE SHËNON RRRITJE



PRISHTINË, 21 JANAR - Dukuria e fajdesë, që nënkupton huazimin e parave të cilat më pas duhet të kthehen me interes shumë të lartë, përveçse konsiderohet ilegale dhe vepër penale, nga policia po cilësohet edhe si shumë shqetësuese dhe e rrezikshme.

Të dhënat e fundit të policisë tregojnë për rritjen e kësaj dukurie.

Përfaqësues të bizneseve thonë se niveli i rritjes së dukurisë së fajdeve vjen si pasojë e qasjes së vështirësuar të bizneseve në financa te bankat komerciale në Kosovë. Në raportin vjetor të publikuar nga Policia e Kosovës thuhet se aktivitetet penale që ndërlidhen me fajde kanë shënuar rritje mbi 13 për qind në vitin 2019 krahasuar me një vit më parë.

Riza Shillova, drejtor i Departamentit për Hetime në Policinë e Kosovës, ka bërë të ditur se ka rritje të aktiviteteve ose të rasteve të krimit ekonomik dhe korrupsionit në vend. "Në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit kemi rreth 43.28 për qind shtim të numrit të rasteve të hetuara në raport me vitin paraprak e, gjithashtu, edhe të rasteve të fajdeve kemi 13.63 për qind rritje të veprave penale apo hetimeve në fushën e fajdeve. Janë hetuar gjithsej 625 raste të krimit ekonomik dhe korrupsionit, janë realizuar 32 operacione, janë arrestuar 253 persona dhe janë paraqitur 537 kallëzime penale", ka thënë Shillova.

Veprimet e tilla kriminale, siç është fajdeja, sipas Kodit Penal

të Republikës së Kosovës, janë të ndëshkueshme. Kodi Penal e parasheh që kushdo që për vete apo për personin tjetër pranon ose kontraktin një shumë dukshëm joproporcionale të pasurisë, në këmbim të shërbimit për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim prej 5 deri në 12 vjet, varësisht nga vlera e humbjeve të mjeteve financiare ose realizimit të pasurisë.

Kryetari i Aleancës Kosovare të Biznesit, Agim Shahini, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se rritja e dukurisë së fajdeve ka ardhur si pasojë e procedurave dhe kriterëve të shumta që kërkohen nga bankat komerciale për aprovimin e një kredie.

"Përderisa bankat komerciale i kanë tkurrur kriteret për t'iu

dhënë bizneseve dhe qytetarëve kredi dhe mbështetur ata shumë, këta të fundit kanë gjetur formën më të keqe që t'i gjejnë njerëzit që kanë përfituar nga krimi i organizuar dhe që japin para me fajde. Kjo dukuri te ne është në rritje për shkak që sundimi i rendit dhe ligjit është i dobët", ka thënë Shahini.

Në Kosovë operojnë 10 banka komerciale dhe 23 institucione mikrofinanciare. Norma mesatare e kamatave për kredi në banka, sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, është 6.4 për qind varësisht nga banka dhe lloji i kredisë, kurse në institucionet mikrofinanciare norma efektive e interesit është 20.1 për qind.

Vlera e kredive në 10 bankat komerciale ka arritur në mbi 3 miliardë euro, kurse vlera e kre-

dive në institucionet mikrofinanciare ka arritur mbi 200 milionë euro.

Ekspertët e ekonomisë në Kosovë në vazhdimësi i kanë konsideruar edhe formë fajdeje normat e larta të kredive të cilat janë zbatuar nga disa institucione mikrofinanciare. Pikërisht normat e larta të interesit kanë qenë arsyeja e mbylljes së dy institucioneve mikrofinanciare vitin e kaluar.

"Iute Credit Europe" dhe "Monego" janë dy institucionet mikrofinanciare që ishin mbyllur. Banka Qendrore e Kosovës në arsyetimin e vendimit për mbyllje kishte theksuar se këto institucione mikrofinanciare, në bazë të mostrave që ka pasur dhe analizuar BQK-ja, kanë zbatuar norma efektive të interesit nga 80 deri në 236 për qind.

## FMN-ja vlerëson punën e ATK-së

Prishtinë, 21 janar (ER) - Është mbajtur takimi përmbyllës i Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili ka monitoruar dhe vlerësuar punën e bërë në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Ky mision në fokus ka pasur vlerësimin e zbatimit të planit afatmesëm të reformës 2019-2021, konkretisht objektivat e parapara në këtë plan, siç janë trajtimi i borxheve

tatimore, avancimi i funksionit të kontrollit tatimor, rimbursimi i TVSh-së si dhe avancimi i teknologjisë informative. Drejtori i përgjithshëm i ATK-së, Ilir Murtezaj, ka falënderuar ekipin e FMN-së dhe është zotuar se do ta vazhdojë edhe më tutje realizimin e objektivave të parapara dhe përmirësimin e kapaciteteve.

Në këtë takim Fondi Monetar

Ndërkombëtar (FMN) ka bërë një vlerësim të jashtëzakonshëm për punën e bërë përgjatë vitit 2019, të cilin vlerësimin e kanë pasqyruar në draftraportin të cilin ia ka dorëzuar drejtorit Murtezaj. Njëkohësisht FMN-ja ka konfirmuar se do ta vazhdojë përkrahjen e saj për zhvillimin e proceseve të rëndësishme të punës së Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).





# Odat ekonomike përshëndesin iniciativën për linjën ajrore Prishtinë - Beograd

Iniciativa e fundit për linjën ajrore Prishtinë - Beograd është mirëpritur nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK). Këto dy oda ekonomike kanë vlerësuar se tregtia e lirë është një faktor esencial në të mundësuarit e rritjes ekonomike përmes efikasitetit dhe inovacionit të shtuar, shkëmbimit tregtar, cilësisë më të lartë dhe çmimeve më të ulëta për konsumatorët e rajonit

sumatorët e rajonit, prandaj barrierat në tregti nuk janë në linjë me frymën e zotimeve të dhëna në kuadër të marrëveshjeve për tregti të lirë, kornizës së bashkëpunimit rajonal të përcaktuar në kuadër të procesit të Berlinit dhe zotimeve të shteteve për avancimin e rrugëtimit në integrimin evropian", është thënë në komunikatën për medie.

Sipas kësaj komunikate, bashkëpunimi ekonomik rajonal vetëm sa do ta përmirësonte perceptimin për rajonin në sytë e investitorëve të huaj, prandaj rinisja e fluturimeve do të ofronte përfitime vitale ekonomike si dhe do të kontribuonte në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe rajonit në tërësi. "Në fund, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Oda Ekonomike Amerikane thërrasin autoritetet në Kosovë dhe në

Serbi t'i ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për implementimin e duhur të marrëveshjes", thuhet në komunikatën e Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Të hënën në Ambasadën Amerikane në Berlin, me anë të një ceremonie, në praninë e ambasadorit amerikan Richard Grenell, përfaqësuesit e kompanisë "Lufthansa" i kanë dorëzuar Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës letrën me të cilën i njoftojnë autoritetet e Kosovës për operimin e aviokompanisë "Lufthansa" në linjën Prishtinë - Beograd. Lidhur me këtë institucionet e Kosovës do ta ofrojnë përkrahjen e nevojshme si për fluturimet e tjera.

Të gjitha fluturimet kërkojnë aprovimet dhe licencat sipas kërkesave rregulatore të zbatueshme në Republikën e

Kosovës si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjen për Hapësirën e Përbashkët Ajrore Evropiane (HPAE (ECAA).

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, Eset Berisha, është shprehur se kjo letër është një hap tjetër përpara për angazhimin e institucioneve të Kosovës për normalizim të plotë të hapësirës ajrore në Kosovë. "Me këtë vihet kontakti në mes dy autoriteteve të aviacionit civil, në mes të Kosovës dhe Serbisë, si partnerë të barabartë. Por, ky është hap i parë drejt normalizimit të plotë të hapësirës ajrore të Kosovës dhe hapjen e korridoreve ajrore me të gjitha shtetet përreth. Nga kjo do të përfitojnë më së shumti qytetarët e Kosovës që shfrytëzojnë shërbimet e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës", ka thënë ai.

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 JANAR - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) dhe Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK) kanë mirëpritur iniciativën për linjën ajrore Prishtinë - Beograd. Këto dy oda ekonomike e konsiderojnë këtë si hap përpara për përmirësimin e marrëdhënieve

ndërfqinjësore dhe lirisë së lëvizjes së njerëzve dhe mallrave ndërmjet shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor. "OEK dhe Oda Amerikane përsërisin qëndrimin se tregtia e lirë është një faktor esencial në të mundësuarit e rritjes ekonomike përmes efikasitetit dhe inovacionit të shtuar, shkëmbimit tregtar, cilësisë më të lartë dhe çmimeve më të ulëta për kon-




## AKP-ja shpalli shitjen numër 54 të aseteve përmes likuidimit


PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka shpallur shitjen e aseteve përmes likuidimit numër 54. Lista e tenderëve për privatizim me këtë valë të shitjeve përmban 93 asete/njësi atraktive të ndërmarrjeve shoqërore në Republikën e Kosovës, të cilat paraqesin një mundësi të shkëlqyer për zgjerim të biznesit apo iniciativa të

reja biznesore në vendin tonë. "Kjo valë e shitjeve me të gjitha asetet e tenderuara është aprovuar në bordin e drejtorëve, kurse AKP-ja i ka njoftuar paraprakisht të gjitha komunat përkatëse se këto asete të ndërmarrjeve shoqërore do të privatizohen dhe ka shpallur njoftimin për tender në faqen e saj të internetit dhe në mediat e

shkruara dhe ato elektronike", thuhet në njoftimin e AKP-së. Sipas këtij njoftimi, ofertat e mbyllura për njësitë/asetet që janë në shitje përmes shitjes së aseteve me likuidim nr. 54 duhet të dorëzohen në "Sallën e konferencave - 'Grand Hotel'", në Prishtinë, më 19 shkurt 2020, kurse hapja e ofertave do të bëhet po të njëjtën ditë.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT  
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU  
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO





## 22 vjet nga sulmi i dytë i forcave serbe mbi familjen Jashari

Skenderaj, 21 janar (ER) - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se sot (e mërkurë) do të organizojë homazhe në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz në përkujtim të 22-vjetorit të sulmit të dytë të forcave serbe kundër familjes Jashari. "Me rastin e 22-vjetorit të sulmit të dytë të forcave serbe mbi familjen Jashari, Komuna e

Skenderajt, në bashkëpunim me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, me datë 22.01.2020, duke filluar nga ora 10:00, do të organizojnë homazhe në Kompleksin Memorial 'Adem Jashari' në Prekaz, në shenjë kujtimi dhe nderimi të luftës së shenjtë çlirimtare të familjes Jashari", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.



## ShKK-ja dhuron gjak për nevojat e qytetarëve

GJILAN, 21 JANAR (ER) - Në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan ka filluar aksioni humanitar për dhurimin e gjakut, në të cilin vullnetarisht kanë dhuruar gjak oficerë korrektues dhe shërbyes civilë nga kjo qendër. Ky aksion u organizua si rezultat i bashkëpunimit në mes të ShKK-së

dhe Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut. Shërbimi Korrektues i Kosovës tashmë e ka bërë traditë organizimin e aksionit humanitar për dhurimin e gjakut nëpër të gjitha institucionet korrektuese dhe është i gatshëm për aksione të tilla edhe në të ardhmen, çdoherë kur qytetarët kanë nevojë.

## Publikohet 'Katalogu i dokumenteve osmane në arkivin Komunal të Prishtinës'



PRISHTINË, 21 JANAR (ER) - Me rastin e 21-vjetorit të themelimit të Arkivit Komunal të Prishtinës, të martën është promovuar libri "Katalogu i dokumenteve osmane në Arkivin Komunal të Prishtinës".

Kryetari i Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se ky libër paraqet një thesar të çmuar për kryeqytetin. "Në vitin 2017 një delegacion i Komunës së Prishtinës, i kryesuar nga nënkryetari Muhedin Nushi, ka zhvilluar një vizitë në Arkivin e Perandorisë Osmane në Stamboll dhe ka arritur të tërheqë mijëra dokumente, në formë digjitale, të kohës së administratës së Perandorisë Osmane,


për dhe nga Komuna e Prishtinës. Sot këto dokumente janë të përkthyer dhe listuara në një libër dhe paraqesin një thesar të madh kulturor e shoqëror, por edhe një potencial të burimeve historike për studiuesit e hulumtuesit e kësaj periudhe historike. Një falënderim i madh për të gjithë që kontribuuan për realizimin e këtij libri, veçanërisht për përkthyesit Besir Neziri, Mead Osmani dhe Agron Islami për recensurën. Po ashtu, falënderojmë edhe Arkivin e Perandorisë Osmane në Stamboll dhe Agjencinë e Arkivave të Kosovës për bashkëpunimin", ka thënë Ahmeti.

## 318 nxënës nga Malisheva përfituan nga një komplet me libra

MALISHEVË, 21 JANAR (ER) - 318 nxënës fitues në garat e organizuara nga Koordinatorin Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport të martën i kanë marrë dhuratat e tyre, përkatësisht kompletet me libra, për rezultatet e treguara në këto gara. Dhuratat janë shpërndarë nga koordinatori Rexhep Hoti, kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi. "Ju jeni arsyeja pse jemi sot këtu, pasi jeni fituesit e garave. Ju keni

një mundësi më shumë në jetë që përmes librit, përkatësisht leximit, t'i arrini qëllimet e juaja në jetë, sepse të gjitha arrihen përmes leximit dhe mësim", ka thënë Hoti me rastin e dhurimit të completeve me libra për të gjithë nxënësit fitues. Ndërsa kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se suksesi i nxënësve malishevas është dhuratë për komunën që drejton. "Ndiem shumë mirë sot, pasi suksesi juaj është dhuratë për tërë komunën. Vetëm me mësim dhe kualitet në mësim

ne mund të ecim përpara dhe ndihem jashtëzakonisht mirë me sukseset që ju keni arritur. Këto nuk janë thjesht dhurata, por vlerësim për suksesin tuaj dhe ju gjithmonë në jetën tuaj do ta mbani në mend këtë moment", ka thënë Begaj. Edhe drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim në Malishevë, Blerim Thaçi, i ka uruar dhe i ka falënderuar për suksesin e arritur dhe për pjesëmarrjen në këto gara, përmes së cilës këta nxënës kanë treguar rezultate të jashtëzakonshme.





Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (7)

# Fluksi i fushës magnetike në pjesën anësore



**Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan**

Eksperimentalisht vërtetohet se sapo t'i mbulojmë polet magnetike (?) dhe (?) fluksi i fushës magnetike në dy polet e magnetit cilindrik do të rritet nga vlera  $1.56 \times 10^{-4}$  Wb në vlerën  $2.45 \times 10^{-4}$  Wb. Siç po shihet kemi një rritje të fluksit të fushës magnetike për 57 për qind në të dy polet e magnetit, e cila e arrin vlerën  $4.9 \times 10^{-4}$  Wb.

Pasi polet e magnetizuara (f) dhe (f) të pllakave të magnetizuara (a) dhe (b) ndodhen në kontakt me polet e magnetit cilindrik (?) dhe (?), jap kuptimin se për shkak të forcës tërheqëse, fluksi i fushave magnetike simetrike (?) dhe (?) që buron nga polet magnetike (?) dhe (?) hyn pa probleme në polet e pllakave të magnetizuara (f) dhe (f) të pllakave të hekurit (a) dhe (b).

Edhe pse do të duhej të kalonte pa probleme fluksi i fushave magnetike, pasi pllakat e hekurit (Fe) magnetizohen kur gjenden në fushën magnetike apo bien në kontakte direkte me magnetet, eksperimentalisht vërtetohet se nga polet magnetike (f) dhe (f), të pllakave të hekurit (a) dhe (b) buron një fluks mesatar i fushës magnetike në vlerat e  $3.74 \times 10^{-5}$  Wb dhe  $3.74 \times 10^{-5}$  Wb.

Siç shihet vlera e fluksit që buron nga pllakat e hekurit (a) dhe (b) zbret për 84 për qind nga vlera e fluksit që magnetometri e

regjistron në polet magnetike (?) (?) në momentin kur polet mbyllen me pllaka të hekurit.

Tani eksperimentalisht vërtetohet se kemi një ndryshim shumë të madh në mes fluksit të fushës magnetike simetrike që buron nga polet magnetike (?) dhe (?) dhe fluksin e fushës magnetike (?) dhe (?) që buron nga polet e magnetizuara të pllakave të hekurit (a) dhe (b).

Duke u bazuar prapë në të njëjtin eksperiment ku fluksi i fushës magnetike përgjatë tërë pjesës anësore të magnetit cilindrik pa prezencën e pllakave të hekurit (a) dhe (b) kishte vlerën  $1.64 \times 10^{-4}$  Wb. Kurse pas vendosjes së pllakave të hekurit (a) dhe (b) mbi polet magnetike (?) dhe (?) fluksi i fushës magnetike përgjatë sipërfaqes së njëjtë të pjesës anësore të magnetit cilindrik ka vlerën  $6.67 \times 10^{-5}$  Wb.

Rezultati matjet eksperimentale na tregojnë se kemi një zbritje të fluksit të fushës për gjatë sipërfaqes së magnetit për 59.5 për qind, në momentin kur mbi polet e magnetit vendosen pllakat e hekurit (a) dhe (b).

Prandaj po t'i krahasojmë rezultatet e fundit do të shohim se kemi një zbritje të fluksit të fushës përgjatë sipërfaqes së magnetit cilindrik.

Kjo zbritje e fluksit të fushës përgjatë sipërfaqes së magnetit simetrik cilindrik, ashtu sikur e kemi sqaruar në botimet e korrikut 2019 në "Epoka e re", ndodhë për shkak të veprimt të fushës antimagnetike.

Fusha antimagnetike buron nga ana anësore e magnetit cilindrik atëherë dhe vetëm atëherë kur polet e magnetit mbyllen me materiale feromagnetike. Por sa është fluksi i kësaj fushe antimagnetike që rrjedhë jashtë poleve magnetike edhe pse nuk kemi një

aparaturë për të bërë një matje të saktë do ta sqarojmë në vazhdim.

## Rritja e energjisë së fushës magnetike brenda poleve magnetike

Një rritje e tillë e fluksit të fushës magnetike për 57 për qind me rastin e vendosjes së pllakave të hekurit mbi polet e magnetit (?) dhe (?), tregon qartë se brenda këtij sistemi nga një energji e caktuar përfitohet një energji me vlerë më të lartë. Por nëse këtu e llogarisim edhe fluksin e fushës magnetike që buron vetëm nga dy polet e pllakave të magnetizuara që ka vlerën e  $7.48 \times 10^{-5}$  Wb, i bie që kemi një rritje për 81 për qind të fluksit të fushës magnetike, pa e llogaritur fluksin e anës së kundërt të pllakave të hekurit (a) dhe (b) në  $5.8 \times 10^{-5}$  Wb. (sqarim fluksi i fundit tregon dy pjesët e tjera që janë në kontakt me polet magnetike).

Gjithashtu vlen të theksohet se kjo rritje e fluksit të fushës magnetike për 81 për qind nuk bllokohet brenda poleve magnetike, sepse këtë e argumenton rënia e forcës tërheqëse për 88,66 për qind në mes sferës së hekurit e varur në mesin e magnetit, e cila rënie shkaktohet nga forca e fushës antimagnetike.

Bazuar në ligjet e natyrës, ashtu sikurse njihen ato nga shkenca e sotme, magneti duhet të harxhojë energji për t'i magnetizuar pllakat e hekurit. Kjo është logjike. Po si ndodhë e kundërta, që në vend të harxhimit, të ketë shtim të energjisë/fluksit të fushave magnetike? Kjo duket se shkon përtej logjikës shkencore, ashtu sikurse njihet magneti sot. E në fakt, është një matematikë e thjeshtë.

Le të sqarohet kjo.

Folur me terme shkencore, kur

pllakat e hekurit vendosen mbi polet magnetike, mund të abstragohet se, në të vërtetë, është një masë që vendoset mbi një masë. Se çfarë domethënë kjo, do të shpjegohet në vijim.

Fakti i parë.

Sot një ndër problemet kryesore të teknikës së automjeteve është pikërisht masa. Në përgjithësi, fjala masë e ka kuptimin e njëjtë. Francezët e përdorin shprehje le poids est l'ennemi de la performance, që domethënë masa është armiku i efikasitetit. Por, duke qenë se fjala është për teknologjinë e automjeteve, atëherë mund të thuhet se masa është armiku i automjeteve. Domethënia e kësaj është si vijon: rritja e masës e rritë ngarkesën e motorit, ngarkesë e cila ndikon në rritjen e harxhimit të energjisë që e përdorë ai. Këtu shfaqet problemi i njohur: rritja e masës sjellë rritjen e harxhimit të energjisë.

Fakti i dytë.

Por te fushat e magnetit ndodhë diçka që e kundërshton faktin e parë. Këtu shfaqet një fenomen i ri, diçka e pazakontë, diçka e panjohur më parë. Sipas logjikës së sotme shkencore, kur të krijohet fusha të reja magnetike, si ato të krijuara nga vënia e pllakave mbi polet e magnetit të cilat praktikisht i mbyllin polet e magnetit, do të duhej patjetër të harxhohet energji e fushës magnetike për t'i magnetizuar pllakat e hekurit. Por, kjo nuk ndodhë. Madje, ndodhë e kundërta. Kjo është një risi, që fizika nuk e njeh ende.

Ajo që është vërejtur është ky fenomen: pas magnetizimit të pllakave të hekurit bëhet një rritje e fluksit të fushës magnetike mbi polet e magnetit, dhe një rënie e forcës tërheqëse në mes sferës dhe mesit të magnetit. Rritje e fluksit të fushave të reja magnetike mbi polet e magnetit

është rritje e energjisë. Kjo gjendje e këtij sistemi mund të qëndrojë në një kohë të pacaktuar. Por dihet nga fizika e kundërshtojnë këtë, ndërkohë që eksperimentet dhe praktika tregon të kundërtën. Si është e mundur kjo? Përgjigja e thjeshtë është se ajo energji nuk humbet, por mbet e njëjtë.

Më tej, duhet theksuar se fluksi i fushës antimagnetike, fushë e cila buron nga ana anësore e magnetit cilindrik kur vihen pllakat e hekurit sipër poleve, mbetet konstant. Kjo vërteton se për sa kohë polet e një magneti mbesin të mbuluara me pllaka nga hekuri, forca tërheqëse në mes mesit të magnetit cilindrik dhe sferës nga materiali i hekurit, mbetet e njëjtë me një zbritje për 88,66 për qind. Këtu shfaqet një problem i ri, i panjohur: energjia mbetet konstante, pra edhe pse shtohet masa, nuk harxhohet energjia po rritet ajo.

Këto dy fakte, kushdo që gjykon me arsye të shëndoshë, ndonëse janë të kundërta, janë reale; te njëri fenomen masa shkakton probleme sepse rrit shpenzimet e energjisë, dhe kjo rritje e shpenzimit të energjisë është e pa ndërprerë, kurse te fenomeni i tjetër masa e rritë energjinë, dhe kjo rritje mbet konstante dhe rrjedhë për kohë të pacaktuar.

Shkencërisht duhet konsideruar fusha magnetike dhe fusha antimagnetike si energji. Duke qenë kështu, një rritje e fluksit të fushës magnetike domethënë një rritje e energjisë brenda një sistemi.

Prej kësaj mund të arrihet te konstatimi se kjo rritje e energjisë, e prekë ligjin mbi ruajtjen e energjisë, e hapë një portë të re, një të kuptuar ndryshe të energjisë: se brenda sistemeve të mbyllura energjia mund të rritet, dhe kjo rritje e energjisë shndërron në punë. (VIJON)




Fig.10




Fig 9



## Konflikti në Libi, embargo armësh ndaj palëve ndërluftuese

Berlin, 21 janar - Udhëheqësit botërorë kanë rënë dakord të mos japin asnjë mbështetje të mëtejshme ushtarake për palët ndërluftuese në Libi dhe të sanksionojnë ata që shkelin embargon e armëve. Por nuk pati asnjë angazhim për të tërhequr mbështetjen ekzistuese ushtarake. Sekretari amerikan i Shtetit Mike Pompeo përfaqësoi ShBA-në në samitin e zhvilluar të dielën në Berlin në një përpjekje tjetër drejt paqes në një vend të ndarë, ku gjenerali Khalifa Haftar sfidon qeverinë e mbështetur nga Kombet e Bashkuara në Tripoli.

Në fund të samitit, kancelarja gjermane Angela Merkel tha se të gjithë pjesëmarrësit, përfshirë palët me interes në konfliktin e Libisë, kanë rënë dakord se paqja në Libi mund të arrihet vetëm përmes bisedimeve, e jo me përdorimin e forcës ushtarake. "Ne duhet të sigurohemi që të gjitha palët që janë në një farë mënyre të lidhura me konfliktin, të flasim me një zë. Ky ishte qëllimi i konferencës së sotme. Sepse vetëm atëherë palët brenda Libisë do të kuptojnë gjithashtu se ekziston vetëm një rrugë zgjidhje - jo ushtarake. Dhe ne e kemi arritur këtë rezultat", tha kancelarja

Merkel.

Samiti u thirr pas një armëpushimi tentativë i ndërmjetësuar nga Rusia dhe Turqia një javë më parë dështoi. Gjenerali i fuqishëm i Libisë Haftar po kontrollon lindjen e vendit dhe mbështetet nga Rusia, Egjipti dhe Emiratet e Bashkuara Arabe. Qeveria në Tripoli, e udhëhequr nga Fayed al-Sarraj mbështetet nga Kombet e Bashkuara, Shtetet e Bashkuara, pjesë të Bashkimit Evropian dhe Turqia. Presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan falënderoi zotin Sarraj për pranimin e armëpushimit dhe i kërkoi Haftarit të bënte të njëjtën gjë.



# Trumpi: ShBA-ja, në mesin e një bumi ekonomik

Në fjalimin e tij pak orë përpara se në Senatin e ShBA-së të fillojë në formën e plotë gjyqi rreth akuzave të ngritura nga demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve që synojnë shkarkimin e tij, presidenti Donald Trump tha se ShBA-ja është në mesin e një bumi ekonomik, të tillë që bota nuk ka parë kurrë më parë



Imran Khan, presidentja e Konfederatës Zvicerane Simonetta Sommaruga, presidentja e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen, si dhe presidenti i qeverisë rajonale të Kurdistanit, Nechirvan Barzani. Në konferencën vjetore të Davosit janë ftuar më shumë se 3,000 pjesëmarrës, ndërkohë që numri i personelit ushtarak dhe

policisë për masat e sigurisë arrin në 5 000.

Qindra protestues, disa të veshur me kostume të koalave për të rritur ndërgjegjësimin për zjarret shkatërruese në Australi, u drejtuan për në Davos duke marshuar përmes një shtegu malor dhe pastaj me tren, pasi autoritetet kanë ndaluar hyrjen në këmbë në këtë qytet alpin.

Ata kërkojnë që udhëheqësit globalë në forum të tregohen më agresivë lidhur me ndryshimin e klimës.

Presidenti Trump foli gjithashtu mbi përqendrimin të rritja ekonomike dhe kundërshtoi ata që i quajti "profetë të pesimizmit me parashikimet e tyre të apokaliptit". "Ata parashikuan një krizë të mbipopullimit në vitet '60, uri masive në vitet '70 dhe fundin e naftës në vitet 90. Këta alarmistë kërkojnë gjithmonë të njëjtën gjë: fuqi absolute për të dominuar, transformuar dhe kontrolluar çdo aspekt të jetës sonë. Ne nuk do t'i lejojmë kurrë socialistët radikalë të shkatërrojnë ekonominë tonë, vendin tonë ose të zhduklin lirinë tonë", tha presidenti Trump.

I pyetur për aktivisten e mjedisit Greta Thunberg, e cila do të hapte një debat për shmangien e një "apokalipsi klimatik" menjëherë pas fjalimit të presidentit Trump, udhëheqësi amerikan tha se ishte njeri që besonte shumë të mjedisi dhe shtoi se dëshironte ajër dhe ujë të pastër.

DAVOS, 21 JANAR - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, përshëndeti arritjen e dy marrëveshjeve të mëdha tregtare dhe tha se amerikanët po fitojnë përsëri si kurrë më parë, ndërkohë që mbajti fjalimin e hapjes në Forumin Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës.

Fjalimi mbahet pak orë përpara se në Senatin e ShBA-së të fillojë në formën e plotë gjyqi rreth akuzave të ngritura nga demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve që synojnë shkarkimin e tij.

Presidenti Trump bëri një përshkrim të atyre që i quajti fitore për punonjësit e shtresës së mesme dhe bizneset, përfshirë fazën e parë të një marrëveshjeje tregtare me Kinën dhe miratimin

nga Senati të një marrëveshjeje të re tregtare me Kanadanë dhe Meksikën, ka njoftuar "voa". "Kur fola në këtë forum dy vjet më parë, ju thashë se kishim filluar rimëkëmbjen e madhe të Amerikës", tha presidenti Trump. "Sot jam krenar të deklaroj se Shtetet e Bashkuara janë në mesin e një bumi ekonomik, të tillë që bota nuk ka parë kurrë më parë", tha ai. Ai u bëri thirrje vendeve të tjera të ndjekin shembullin e tij dhe të çlirojnë qytetarët e tyre nga "burokracia shtypëse".

Në agjendën e presidentit Trump para kthimit në Uashington të martën pasdite ishin takimet me disa udhëheqës botërorë, mes të cilëve presidenti i Irakut Barham Salih, kryeministri pakistanez

## "Nënat e Srebrenicës" ngrenë padi kundër Holandës

SARAJEVË, 21 JANAR - Të afërm të viktimitave të Masakrës së Srebrenicës ngritën padi kundër Holandës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg.

Padia, e cila sfidon një vendim të Gjykatës së Lartë në Holandë, të muajit korrik, është përpjekje e grupit të njohur si "Nënat e Srebrenicës" për ta mbajtur Qeverinë holandeze përgjegjëse për vrasjen e 350 burrave myslimanë. "Nënat e Srebrenicës ngritën sot një rast kundër shtetit holandez në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut", thanë përmes një

deklarate avokatët Marko Gerritsen dhe Simon van der Sluijs, duke e akuzuar shtetin holandez për mosmarrje të masave të mjaftueshme për të mbrojtur popullsinë.

Në total, mbi 8 000 burra dhe djem myslimanë janë vrarë nga forcat serbe të Bosnjës, të udhëhequra nga gjenerali Ratko Mlladić, në korrik të vitit 1995 në Srebrenicë.

Atëbotë, shumë prej viktimitave kanë shkuar në zonën e shpallur të sigurt nga Kombet e Bashkuara, por atje nuk ka pasur numër të mjaftueshëm të paqeruajtësve holandezë për t'i mbrojtur ata.

Gjykata e Lartë e Holandës konstatoi më 19 korrik se paqeruajtësit holandezë të Kombeve të Bashkuara "kanë vepruar në mënyrë të paligjshme" kur i kanë evakuuar burrat nga baza e tyre ushtarake pranë Srebrenicës, më 13 korrik, 1995, duke i dorëzuar ata te forcat serbe të Bosnjës, edhe pse e kanë ditur se "kanë qenë në rrezik serioz për t'u abuzuar ose vrarë". Megjithatë, Gjykata e Lartë tha se Holanda mban përgjegjësi "shumë të kufizuar".

Sipas vendimit të Gjykatës, Holanda ka vetëm 10 për qind të përgjegjësisë për vdekjen e



350 burrave.

Avokatët e "Nënat e Srebrenicës" thanë se ky vendim ishte "krejtësisht arbi-

trar". Masakra e Srebrenicës është cilësuar si më e rënda në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore.



# SIGMA

## VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË

### NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,  
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:

• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.

Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.

**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

### NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

Dear clients and interested parties,

We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:

• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.

We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.

**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

### OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

Dragi klijenti i zainteresovane strane,

Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajućeg društva Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:

• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.

Me ćemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajućeg društva na gore navedenu novu adresu glavne kancelarije.

**Hvala vam na razumevanju i dobrodošli u nove kancelarije!**



**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**

Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net) [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net)





# Ilire Vinca: Në teatër, komunikimi me publikun është gjithmonë i freskët, kurrë njësoj

**Intervistoi: Anila DEDAJ**

Drama "Natën, má" e Marsha Norman, fituese e çmimit "Pulitzer", ka qenë ndër më tronditëset për gati dy sezona në kryeqytet, Tiranë. Nën regjinë e Ema Andreas, dy aktore - Ilire Vinca nga Kosova në rolin e nënës dhe Egla Ceno në skenë si e bija, - kanë përshkuar tensionin psikologjik që shkakton depresioni dhe pas tij, ideja e vetëvrasjes. Nëna përballë së bijës nuk mundën të ndryshojnë fatin e njëra-tjetrës, përpos të realizojnë një tablo të hapur, mbi ç'ndodh brenda qenies në këto pëshpërime vdekjeprurëse të fjalës. Interpretim me forcë e thellësi psikologjike prej të dyja aktoreve. Por për publikun shqiptar është e rrallë të shihet profili i një aktoreje me fibra artistike aq të kuruara sa tek Ilire Vinca. Me përvojën e skenës së teatrit, por edhe në kinema, Vinca sjell këtë rrëfim:

**Zonja Vinca, 25 vjet karrierë në kinema dhe në teatër. Nëse kthehemi në retrospektivë, si lindi dëshira për t'u marrë me aktrim?**

**I. Vinca:** Një histori që zanafillën e ka shumë të herët dhe që ndoshta tek unë ka lindur në atë fazë kur njeriu ende nuk mund të vetëdijesohet për të ardhmen e tij, para se të artikuloja mendimet. Diçka e tillë ndoshta ka ndodhur, pasi unë jam rritur mes poezisë, artit e këngës, falë edhe babait tim, i cili është poet dhe studiues i letërsisë. Nuk mund ta mohoj se kur erdhi momenti që unë duhet të vendosja, të zgjidhja profesionin, kam pasur shumë dilema, sepse isha e tërhequr nga fusha të tjera të artit krahas aktrimit, si muzika dhe piktura. Mirëpo ndonjëherë në jetë vijnë disa momente që, në njëfarë mënyre, të përcaktojnë fatin. Për mua ndodhi kur duhet të bëja regjistrimin, për kohëzgjatje u hap dega e Arteve Dramatike në Prishtinë (1989). Mirëpo ndodhi që u pajisa me dy indekse: nga njëra anë, nëna donte të më siguronte një profesion më të sigurt,

si mjekësia, nga ana tjetër, babai nuk hoqi asnjëherë dorë dhe gjithmonë e përforcoi edhe më shumë dëshirën time për t'u marrë me art. Kështu i ndoqa të dyja deri në vitin e tretë, deri në kohën kur shkollat shqipe u mbyllën (1990-1991) dhe ne dolëm nga objektet shkollore. Pra, gjeografikisht, u bë e pamundur që t'i ndiqja të dyja degët, por nuk ishte vetëm kjo... Unë ndodhesha në një pikë që isha pjekur mjaftueshëm sa për të vendosur përfundimisht drejtimin që doja të merrja. Pra, duhet të jepja maksimumin tim në një prej tyre dhe profesioni, në njëfarë mënyre, të më përmbushte. Kështu zgjodha artin! Që një zgjedhje e bërë me shumë lehtësi. Nuk pata asnjë dilemë, e dija se duhet të isha një aktore më shumë dhe jo një mjekë më shumë. Më dukej sikur mjekë kishte mjaftueshëm.

**Karakterizoheni gjithashtu nga mirënjohja, edhe kur flisni për pedagogun tuaj Faruk Begollin... I. Vinca:** Të thuash se Begolli ishte

një profesor i mirë, është pak. Ishte i jashtëzakonshëm. Nuk është kujdesur vetëm për edukimin tonë përmes leksioneve të aktrimit, por ka ndikuar te secili prej nesh, për sa i përket orientimit tonë si qenie njerëzore. Gjithmonë duke mbjellë dashuri dhe respekt ndaj njëri-tjetrit, duke kultivuar disiplinën e punës. Përpiqej që të evidentonte pikat tona të forta si aktorë, karakteristikat specifike. Sepse, edhe pse ne mund të jemi të gjithë aktorë, asnjë nuk del nga shkolla i njëjtë si tjetri. Ai ka bërë të mundur që çdokush nga ne të dalë nga shkolla e të bëjë atë që di të bëjë më së miri. Ishte shumë i afërt dhe njëherazi, shumë i rreptë. Një kombinim i përsosur! Kur ne festonim deri në orët e vona ndonjë premierë, e dinim se duhet të ishim fiks në kohë në prova të nesërmen, pasi nuk kishte asnjë tolerancë. Është kujdesur vetëm për edukimin tonë përmes leksioneve të aktrimit, por ka ndikuar te secili prej nesh, për sa i përket orientimit tonë si qenie njerëzore.

Gjithmonë duke mbjellë dashuri dhe respekt ndaj njëri-tjetrit, duke kultivuar disiplinën e punës. Përpiqej që të evidentonte pikat tona të forta si aktorë, karakteristikat specifike. Sepse, edhe pse ne mund të jemi të gjithë aktorë, asnjë nuk del nga shkolla i njëjtë si tjetri. Ai ka bërë të mundur që çdokush nga ne të dalë nga shkolla e të bëjë atë që di të bëjë më së miri. Ishte shumë i afërt dhe njëherazi, shumë i rreptë. Një kombinim i përsosur! Kur ne festonim deri në orët e vona ndonjë premierë, e dinim se duhet të ishim fiks në kohë në prova të nesërmen, pasi nuk kishte asnjë tolerancë.

**Keni prekur suksese si në teatër ashtu edhe në kinematografi. Si e ruani balancën mes ekranit dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me publikun? Si ka ndryshuar Ilirja gjatë këtyre viteve, duke bërë që regjisorët ta përzgjedhin si protagonisten e shfaqjeve/ filmave të tyre?**

**I. Vinca:** Ka edhe të tjerë kolegë që janë aktorë si në teatër ashtu



edhe në kinematografi. Mendoj se kjo balancë nuk është shumë e vështirë për t'u mbajtur, mjafton të krijosh një shenjë dhe të kuptosh si duhet të luash në skenë e si në shesh të xhirimit. Ndoshta të tjerët mund të flasin më mirë për atë që shohin tek unë. Ajo që unë mund të them me siguri, është se e dua punën që bëj dhe është pikërisht ky starti i gjithçkaje.

#### Në momentin që ju pranoni një rol, si futeni në petkat e personazhit?

**I. Vinca:** Fillimisht, është leximi i parë i pjesës, që mandej të perceptoj përshtypjet e mia të para dhe t'i shkruaj, pasi janë shumë të rëndësishme. Mandej duhet të jesh shumë i durueshëm për të zbuluar çdo shtresë të personazhit dhe kjo duhet bërë pa rënë në grackën e demonstrimit, por duke mbetur të përjetimi. Pra, duhet të veshësh të gjitha karakteristikat që personazhi ka, jo vetëm një aspekt. Të arrish një dimension brenda kontekstit, që t'i afrohet sa më shumë spektatorit me të gjitha dilemat, pyetjet që mund t'i zgjohen pas asaj shfaqjeje. Do të ishte mirë që pas atij roli, ndonjëherë të ketë edhe debate në publik, që ishte apo nuk ishte kështu. Pra, duhet të sjellësh diçka që t'i ngacmojë dhe t'u afrohet sa më shumë.

#### Ndër rolet që keni interpretuar, a ka ndonjë prej tyre ku ndoshta e keni gjetur më shumë veten?

**I. Vinca:** Secili prej roleve të mia ka diçka të ngjashme me mua, sepse vjen prej meje, buron nga unë. Çdokush nga ne ka një botë të tijën emocionale, një mënyrë specifike se si i qaset punës, se si e shohim një personazh. Jam e bindur se rolet e mia mund t'i luajë shumë bukur edhe një tjetër aktore. Nuk është se e kam zbuluar unë Telmën dhe asnjë Telmë tjetër nuk do të funksiononte. Ka shumë Telma në botë, po aq sa ka edhe aktore, dhe mendoj se secila prej tyre do ta zbulonte më të



bukurën nga vetja brenda një roli. Kështu që mendoj se rolet e mia kanë pak Ilire, por njëherazi rolet janë edhe një vulë, një gjurmë tek Ilirja. Këtë e shikoj po ashtu si një kombinim shumë të bukur.

#### Dhatë në skenën e teatrit në Tiranë "Natën, Má", një shfaqje e fortë dramatike, ku ju sillni emocione tronditëse të një nëne. Si e keni përjetuar këtë rol si aktore, por edhe në një aspekt më personal, si nënë e tri vajzave?

**I. Vinca:** Është një rol, një proces shumë kompleks. Kjo, pikësisht falë tekstit fantastik, pastaj edhe për bashkëpunimin që arrihet. E ndaj fatin e nënës dhe së bijës me një aktore si Egla Ceno, në një mënyrë shumë të bukur, që përcjell ndjeshmëri të lartë. Mandej Ema është e jashtëzakonshme dhe i kushton vëmendje maksimale çdo nuance që ne duhet të kërkojmë dhe të nxjerrim nga vetja. Kjo pjesë më ka bërë që jo vetëm si nënë e tri vajzave të kthej sytë nga vetja, ta vëzhgoj veten, duke pyetur: A ka pasur një moment që unë kam qenë kështu, që kam reaguar në këtë mënyrë?! Pastaj jam kthyer edhe më në kohë, si bija e një nëne, duke pyetur përsëri veten: A kam qenë kështu ndonjëherë? Si jam sjellë me "nanën" e si ajo me

marrëdhënie shumë të afërt dhe dialogojmë lehtë. Kemi punuar shumë të dyja palët në këtë aspekt, i jam dedikuar shumë kësaj pjese.

#### Ju jeni gjithashtu pedagoge për artet në Prishtinë. Si e shikoni ecurinë e aktorëve të rinj? A ka mes tyre talente?

**I. Vinca:** Mendoj se po rritet një brez i ri artistësh shumë të talentuar. Duke punuar si pedagoge e vërej këtë, mirëpo fati i keq i tyre është se Kosova ka mbetur ende e izoluar. Është diçka të cilën ne e përjetojmë, një padrejtësi shumë e madhe që na është bërë. Një izolim i tillë nuk ka të bëjë vetëm me faktin se dikush duhet të ngjitet në avion e të shkojë në një tjetër vend, por ka të bëjë me dhunën e peshën psikologjike që njeriu e pëson kur është i izoluar dhe nuk ka mundësi për të bërë një zgjedhje të lirë. Ndikon shumë, ndikon keq nga ana psikologjike. Pra, tek të rinjtë nga ky fakt has një lloj shuarjeje të shpresës, mbyllje të vizionit. Diçka e tillë bën që motivimi për punën të bjerë, sepse ata mendojnë se ajo që bëjnë qëndron brenda një kornize, vetëm brendapërbrenda. Në këtë mënyrë, fillojnë kompromiset me veten, çka bën që ndonjëherë të mos hapen disa dyer të cilat, edhe pse mund të mos jemi të vetëdijshëm, janë aty për ne. Izolimi ndihet, është një peshë që e ndiej si pedagoge dhe profesioniste. Shpresoj që diçka e tillë të ndryshojë shumë shpejt, pasi do të ndryshonte mentalitetin dhe qasjen ndaj punës së tyre, sepse fakti që puna mbetet vetëm brenda kufijve, shpesh demoralizon. Zbeh dëshirën, ndjenjën e vetëvlerësimit të ballafaqimit jashtë kufijve. Izolimi mund të bëhet konsumues.

#### Është një komunikim, siç e thatë edhe ju, shumë kompleks nënë e bijë ai i Telmës me Xhesin. Sa e vështirë është të arrihet kjo urë dialogimi mes palëve në jetën reale, të kuptohesh, të kuptosh dhe të bësh një zgjedhje?

**I. Vinca:** Është e vërtetë, në këtë shfaqje shkojmë drejt komunikimit me një vështirësi të madhe. Diçka që unë nuk e has gjithmonë me vajzat. Pra, si prind, duke dashur të bësh më të mirën, nuk e di se cilën rrugë të zgjedhësh. Nëse duhet të thuash "Po", apo "Jo". Mandej janë dilemat se deri ku duhet ta nxitësh. Dilema të mëdha e komplekse që vijnë me shumë ngjyrë. Në shfaqje ndodh komunikimi nën një presion shumë të madh. Ndërsa unë me vajzat kemi një

**Dy vjet më parë u nominuat nga League of Professional Theatre Women në New York si një nga 20**

**aktoret më të mira në botë, ndërkohë që jeni vlerësuar me çmime të tjera të rëndësishme. Si i përjetoni të tilla suksese?**

**I. Vinca:** Një shprehje e mençur thotë: "Lajkat, çmimet, janë të bukura, duhet t'i shijosh, por të mos i mbash afër. Duhet lënë anash." Pra, sado që të na gëzojnë, i konsideroj më tepër si një dëshmi se puna duhet të vazhdojë më me seriozitet, përkushtim dhe dashuri. Ndonjëherë më gëzojnë më shumë fjalët e njerëzve, mbështetja e publikut, energjia që ai më jep duke më shpërblyer punën që çdo ditë kam bërë në kinema apo teatër.

#### Cilat janë emocionet që përjetoni pas një shfaqjeje? A ka ndonjë moment që mund të veçonit?


**I. Vinca:** Ka shumë... Çdo shfaqje, çdo publik, çdo individ që vjen në sallë, më sjell diçka me vete. Përjetimet e publikut janë të veçanta, asnjë natë nuk është njësoj. Mendoj se është kjo që e bën të bukur teatrin, që një person, aktor, i jep jetë një personazhi, duke krijuar njëherazi një audiencë të re. Kontakti me publikun është gjithmonë një komunikim i freskët që ndodh aty për aty dhe që nuk përsëritet asnjëherë njësoj. E vërtetë që i jap shumë publikut, por edhe marr shumë prej tyre.

#### Dikur patët mundësinë për t'u bërë mjeke, duke iu dedikuar këtij profesioni për tre vjet. Nëse do të ktheheshit pas në kohë, do të rizgjidhnit përsëri aktrimin?

**I. Vinca:** Mendoj se po! Kam shumë imagjinatë dhe ndonjëherë fantazoj: po sikur të isha bërë kështu? Po sikur të kishte ndodhur kështu? Ne kemi një shans të vetëm dhe jetën nuk mund ta paramendojmë, as të kthehemi pas e të shohim se si do të kishte qenë, por unë jam shumë e kënaqur për zgjedhjen që kam bërë. Siç e thash më sipër, jap shumë nga vetja, por njëherazi marr po aq nga të tjerët. Diçka e tillë më bën një njeri shumë të lumtur! /Exlibris.al





Samuel  
Beckett

# Si kapërceva rrethimin për të takuar Samuel Beckettin

František Janouch, një fizikan bërthamor, tregon peripecitë e një udhëtimi për të takuar dramaturgun e famshëm Samuel Beckett në Paris me porosi të mikut të tij Václav Havel

Në vitin 1982, Samuel Beckett i kushtoi një dramë të re të titulluar Katastrofa, Václav Havelit, i cili në atë kohë ishte një i burgosur politik në Çekosllovakë, i dënuar me katër vite e gjysmë për "veprime subversive". Havel e falënderoi Beckettin që i kushtoi dramën Katastrofa. "Për një kohë të gjatë pas kësaj," shkruan ai, "në burg më shoqëroi një gëzim dhe emocion i madh, i cili më ndihmoi të jetoja midis gjithë pislëkut dhe poshtërsisë".

Kur Havel u lirua vitin tjetër, ia ktheu nderin Beckettit duke i kushtuar një dramë të titulluar Gabim. Kjo është diçka pak e njohur nga karriera e të dy shkrimtarëve. Dramat u luajtën bashkë në Stockholm në vitin 1983 dhe u botuan për herë të parë në vitin 1984, në revistën Indeks mbi censurën.

Personi i parë që i kërkoi Havelit të shkruante një dramë kur doli nga burgu, ishte miku i tij, František Janouch, një fizikan bërthamor, të cilit i kishin dhënë azil politik në Suedi, në vitin 1974. Më vonë ai themeloi Fondacionin Charter 77, për të mbështetur lëvizjen e disidentëve në vendlindjen e tij. Pas lirimit të Havelit, Janouch shërbeu si ndërmjetës në një shkëmbim letrash midis Beckettit dhe kolegut të tij dramaturg.

Janouch-it më pas i erdhi një ide. Ai i kërkoi Beckettit nëse mund ta vendosnin në skenë Katastrofën, së bashku me Gabimin. "Regjisori i shkriu në një shfaqje, që njerëzit të cilët nuk i njihnin këto drama, ta kishin të vështirë të dallonin se ku mbaronte Haveli dhe ku fillonte Beckettin".

Për punë teatri jam kokë e këmbë diletant, barbar diletant madje. Për të vajtur në teatër nuk më mbetet kohë fare, sidomos kur jam në Suedi, ku kohën e kam më të kursyer se kudo gjetiu; nuk jam shikues i rregullt e i përkushtuar i teatrit, edhe për një arsye tjetër: nuk e marr vesh mirë atë që flitet aty, kuptoj diçka ndërmjet 50 e 80 përqindshit, në varësi të akcentit të veçantë të aktorëve dhe akustikës së sallës.

As për Beckettin [Beckett] nuk dija shumë gjëra. Vërtet vite të shkuara pata parë Në pritje të Godosë, pata lexuar do tregime të tij të stilit absurd, dhe pata ndjerë se ai mund të hynte në radhën e atyre që quhen mjeshtrë klasikë. Por thellësinë dhe madhësitinë e fuqisë së tij artistike munda ta përvijoj vetëm kur lexova një letër për Beckettin, që Václav Haveli [Václav Havel] e shkroi pasi doli nga burgu. Për Havelin Becketti ishte Perëndi e zbritur nga Olimp, kurse mua, një fizikan i thjeshtë e vdekatar, po më binte për hise t'ia dorëzoja këtë letër. Mirëpo, për dorëzimin e letrës, qysh në fillim më dolën do pengesa. Becketti nuk kishte kurrfarë adrese postare. Pas hulumtimesh, që më morën goxhë kohë, rashë në gjurmë të agjentit të tij letrar (në të vërtetë, tek ai më shpuri një miku im, aktori Ivo Palec) i cili më tha, se do të bëja mirë, që letrën për Beckettin t'ia dërgoja me postë restante botuesit të tij në Paris. Si shkrova veçan do rreshta në frymë shoqërore, ua nisa atyre. Nuk kaloi shumë dhe mora përgjigjen e Beckettit, së bashku me një letër të shkurtër, që duhet t'ia dorëzoja Havelit. Ende duke e marrë si diçka

të zakonit, pa e ditur se isha bërë lajmëtar ndërmjet një Perëndie dhe një njeriu vdekatar, nuk ma mori mendja se shënimi i shkruar me bojë të zezë, me shkronja të imta, të ntrashura fort në letër prej dore njeriu të moshuar, do ta ngazëlente marrësin aq fort. Václavi vërtet u ngazëllje pa masë: e ndjeu veten krenar dhe letrën e Beckettit e vuri në xham, në mënyrë që ta soditnin të gjithë miqtë e vet. Kryehyu Beckett kishte zbritur poshtë në Tokë dhe i kishte shkruar disa rreshta me dorën e tij. Unë, nga ana ime, i dërgova Beckettit një pusullë të shkurtër për t'i thënë sa ngazëllim kishte ngjallur përgjigja dhe libri që ai i solli Havelit. Becketti u përgjigj edhe ai me një pusullë të shkurtër, bashkangjitur me një çek të majmë për Fondacionin Karta 77.

I shkrova prapë për ta falënderuar, dhe me kaq kapitulli i Beckettit u mbyll - për aq sa kishte të bënte me mua, si i pafë e shpirt mëkatar që jam. E, megjithatë, më duhet të them se iu betova vetes që, me rastin e parë, pa tjetër do të shihja ndonjë pjesë të Beckettit.

\*\*\*

Në vjeshtën e vitit 1983 m'u dha t'i hyj teatrit me zulmë të madhe, matanë perdes së skenës. Jo si spektator - po si, kush isha unë? As agjent teatri, as regjisor, as aktor, as dramaturg e as drejtor teatri. Thjesht, njeri që nuk shihja shfaqje teatrore.

Iu luta Havelit të shkruante një mini-pjesë për një mbrëmje në një teatër, të planifikuar për muajin tetor dhe të organizuar prej disa prej aktorëve më të shquar suedezë në Stockholm.

Václavi mirënjohës pjesën teatrale ma solli, dhe kështu, pa pritje e pa kujtuar, u gjenda mes veprimtarishë dhe një mjedisi krejt të panjo-

hur për mua. Të gjithë të panjohur: regjisori, drejtori i teatrit, aktorët e aktoret, asistent-regjisorët, agjentët teatrore, si dhe të gjithë ata, që ende nuk i kam pjekur, përkthyesit, punonjësit e sallës, ata të biletarisë dhe reklamës; për mua kuturisje e vërtetë, madje e pandalshme. M'u kujtuan xhindet që dalin nga shishja. Kush ka kënduar rrëfenja orientale, e di sa e vështirë është t'i mbledhësh prapë e t'i mbyllësh në shishe.

Rreth 5-6 javë para premierës, më shkrep një mendim: të shtypnim një fletë-palosje, me siguri do të pritej mirë. Ideja ime ishte të botonim letërkëmbimin e Havelit me Beckettin, dhe këtë e bisedova me regjisorin Stefan Böhm. Ai ma pëlqeu idenë dhe u tregua entuziazat, sidomos pasi i këndoi vetë të dyja letrat. Po si i kishin rënë në dorë Havelit? Natyrisht, prej meje. Dhe përse ato letra ndodheshin tani në dorën time? Doemos del nevoja ta sqarojmë, se jetojmë në një periudhë normalizimi, që është thellësisht jonormale, aq sa unë nuk mund t'ia dërgoja letrën e Havelit, me atë deklaratë të rëndësishme që përmante, një adrese të pasigurtë pariziene dhe, po ashtu, nuk mund t'ia përcillja Havelit përgjigjen e Beckettit pa i bërë një kopje, për ta patur në rast se nuk i binte në dorë. Me shërbimin postar suedez nuk kam përvojë edhe aq të mirë. Kam patur letërkëmbim të shpeshtë me ta, duke harxhuar disa mijëra korona suedeze për letra të humbura, të postuara prej meje drejt Lindjes dhe Jugut e që nuk mbërrinin në vend. Mirëpo, për botimin e dy letrave më duhej pëlqimi i të dy autorëve. Haveli ma dërgoi menjëherë. Beckettit i bëra një kërkesë tjetër, duke i shpjeguar si kishte ndodhur që kisha një kopje të letrës e që duhej për programin e asaj mbrëmjeje. Autori i dramave të

teatrit absurd nuk pa asgjë absurde në kërkesën time. I shkrova që mundësisht të më përgjigjej me telegram a me telefon dhe kështu, një mbrëmje, më ra zilja e telefonit. - Samuel Becketti jam, - dëgjova një zë të thellë njeriu të mplakur.

U shtanga, por m'u dha të mendoja sa do të ishte shtangur vetë Václav Haveli në atë çast.

- A mund të flas me Z. Janouch?

- Uuunë jaam, - mezi belbëzoja.

- E mora letrën tuaj. Natyrisht, mund ta botoni letrën time dërguar Václav Havelit. Po, të të pyes një herë, si është ai?

Becketti ia shqiptoi emrin me një tingëllim frengjisht, vaklavel. Dihet se francezët e kanë problem shqiptimin e H-së nistore, vështirësi që mund të krahasohet me atë të kinezëve, të cilët nuk e shquajnë në shqiptim R-në nga L-ja.

- Bëjini të fala prej meje, ju lutem.

Zura t'i flas për Havelin dhe, me që unë nuk jam Haveli, dhe prandaj edhe i hutuar disi më pak nga thirrja telefonike e Beckettit prej Olimp të tij, më shkrep një ide (Mua kurrë nuk më shterojnë idetë. Si ishte ajo sarkazma e hollë e Ostop Benderit: idetë - tonat, paratë - tuajat):

- Zoti Beckett, a ka mundësi që në atë mbrëmjen e Stokholmit, të luajmë edhe pjesën tuaj Katastrofa që ia keni kushtuar Václav Havelit? (Më duket se edhe unë ashtu ia shqiptova, "vaklavel")

- Pa tjetër mund ta luani, po ua jap pëlqimin qysh tani, kurse tekstin e pjesës do t'ju dërgoj së shpejti.

\*\*\*

Regjisori Böhm sa nuk po fluturonte nga gëzimi. Premiera botërore e të parës pjesë të shkruar prej Havelit mbas katër vjetësh burgu dhe premiera suedeze e pjesës së Beckettit - të dyja bashkë në një mbrëmje dhe të dyja bashkë besuar



një regjisor të ri të një teatri të vogël "Fria Proteater" - për më tepër në një sallë të madhe teatri qyteti, që ne po kuturismim ta mbushim plot e përplot.

Mirëpo, unë këtu nuk e kam fjalën te mbrëmja jonë, e kam fjalën te Beketi. Rreth dy javë para natës së parë të shfaqjes më telefonoi një kritik teatri suedez i mirënjohur. Kishte takuar Beketin në Paris dhe kishin biseduar për mua.

- Si ia dole të lidhesh me të? - më pyeti. - Beketi u bën bisht njerëzve, nuk takon kërënd dhe jeton krejtësisht i mbyllur në botën e vet. Druaj se përgjigja ime nuk mbushi mendjen.

- Si nismëtar shërbeu Haveli; unë as nuk e kisha haberin për madhësitë e Beketit, për të si fenomen i jashtëzakonshëm në botën e teatrit - unë kujtoja se ai qe një vdekatar i zakonshëm, si të gjithë.

Për të mos hyrë në hollësi të panevojshme: ne këmbuem letra për të drejtën e autorit, unë i dërgova një informacion për mbrëmjen me shfaqjen e suksesshme në Stokholm dhe - në shenjë falënderimi ndaj Beketit për mirëkuptimin dhe ndihmesën e tij - i shkrova se do t'i dërgoja një print punimi në grafikë, të frymëzuar prej pjesëve të tij, dhe të bërë prej një piktori çek.

Ai më falënderoi ende pa e marrë dhuratën - kurse një muaj më pas tubi me printin e grafikës m'u u kthye mbrapsht në Stokholm. Botuesi në Paris e kishte ridërguar pakon rekomande me adresën e shtëpisë së Beketit, por ai nuk kishte vajtur në postë për ta marrë. Me këtë mënyrë ia mora vesh adresën e shtëpisë në Paris.

Beketi nuk kishte pse të bëhej merak fare: unë nuk do t'ia tregoja adresën askujt mbi dhë dhe do ta respektoja inkonjton e burrit të moshuar.

Pasuan dy letra të tjera të shkurtra. Beketi më njoftoi adresën e një botuesi tjetër për t'i dërguar printin e grafikës. Kur e mori, më falënderoi përsëri me letër.

Po bëhesha gati për të kaluar fundjavën e 1 prillit në Paris. Kisha patur një si mbledhje diku në Zvicër - kurse Parisi është qytet i këndshëm për të kaluar fundjavën, sidomos kur kostoja e biletës së avionit për në Zvicër është njëlloj edhe kur kalon nga Parisi.

Nuk e di sesi më shkrep: i shkrova Beketit se do të vija në Paris, dhe se do të doja të trokitja në derën e tij, nëse nuk do të ma merrte për serbesllëk të tepruar; doja ta falënderoja personalisht për gjithçka pati bërë për ne. Nëse qe e vulltshme për të, a do të linte një njoftim në adresën time të Parisit, mundësisht?

Në Paris, unë kam kafazin tim të vockël, një papafingo të ngrohtë në Lagjen e Hebrenjve, rreth 150 metro larg Rue de Rivoli. Me thënë të drejtën, papafingoja e ngrohtë nuk është e imja, unë kam vetëm çelsin e saj, si dhe një ftesë të përhershme për ta përdorur sa herë vij në Paris. Atje hyj si në shtëpinë time, portieri më përshëndet si me qenë banor i rregullt... Ç'mund të them tjetër? Përfytyroni qoshen më romantike të Parisit.


Mbërrita në Paris të premten në mbrëmje. Në dhomë më priste një pusullë e Beketit.

Ai do të ishte në hotelin PLM Saint

Jacques, të djelën më 1 prill në orën 11. "Ejani, po të keni mundësi".

Zakonisht, në Paris nuk kam as edhe një minutë të lirë. Kam shumë të njohur, po dhe restaurante të mira ka shumë, e po ashtu edhe ekspozita interesante sa të duash.

Është mbrëmje të shtune - papafingoja ka një mungesë të ndjeshme, e cila mund të shihet edhe në mënyrë dialektike e të kthehet në të kundërtën e vet, në epërsi të madhe: nuk ka telefon. Gjithmonë më duhet ta kem xhepin plot me monedha si dhe durim derri për të prituri sa të lirohet kabina telefonike. Kabinat telefonike në Paris më ngjallin, herë pas here, një farë



ndjenje të mbrapshtë raciale - nuk mund ta merrni me mend sa e tjerin muhabetin arabët, dhe dihet se telefonat praktikisht përdoren pa pushim prej arabëve.

Kështu, pra, të shtunën në mbrëmje dola për të bërë një numër telefonatash. Po shkonte ora dhjetë. Një gjysëm ore më pas, arabi, që më ra për pjesë, liroi kabinën. Bëra telefonatat dhe lashë disa takime. Më mbetën edhe disa franga. I telefonova një miku, një kolegu fizikan me emër muzikor, Franc Lehar. Më tha të merrja trenin e parë dhe të shkoja tek ai. Shtëpia e tij e re ishte në përfundim e sipër, dhe veç kësaj, sapo kishte ardhur nga Bota e Re një miku ynë i përbashkët, të cilin nuk e kisha parë prej vitësh. Kundërshtimi im, se kisha lënë shumë takime të tjera dhe nuk kisha kohë fare, u hodh poshtë energjikisht me porosinë e rreptë "merr pizhamat dhe furçën e dhëmbëve, pas një ore më ke në stacion". Harrova t'ju them se Fransuai banon rreth 40 km jashtë Parisit, po dhe ishte orë e vonë e së shtunës në mbrëmje... Por e mira është se Metroja nuk të lë në baltë, trenat e saj janë të shpeshtë dhe të shpejtë. Në stacion sosa para mikut tim. Arrita, për habinë time vikinge, të mbledh do bisqë të njoma me lule qershie të egër për zonjën e shtëpisë.

Habi e madhe, para pak ditësh isha larguar nga Suedia plot ngrica, kurse këtu pranvera kishte çelur me të gjitha.

Ndenjëm shtruar dhe u fjalosëm me gotat e konjakut përpara e me zjarrin e kërcunjeve të thatë në oxhak.

- Duhet të ngrihem në orën tetë të mëngjesit, - thashë unë, - Beketi më pret më njëmbëdhjetë.

Një dush me ujë të ftohtë akull më nxori gjumin e më këndelli. Në garazh - befasi e pakëndshme: bateria e makinës kishte rënë plotësisht.

Duhet të shkoja pa tjetër, Vaclavin nuk mund ta zhgënjeja kurrsesi. Zura të mendoj si t'ia gjeja çaren, si

të arrija në Paris nga ky cep i humbur këtë mëngjes të djele, kur e gjithë Franca ende fle.

I pata telefonuar Havelit të shtunën në mbrëmje për t'i thënë se do të takoja Beketin. Ma ktheu me thumb se ai vetë nuk do të guxonte të takohet me të, dhe se, përveç kësaj, nga emocioni për mua, atë natë nuk do të mbyllte sy fare.

Vumë aparatën për të ngarkuar baterinë dhe sa nuk po më këputeshin nervat tek shihja se akrepi i orës sime të dorës lëvizte me shpejtësi, kurse gjilpëra e aparatit mezi luante vendit. Pas njëzet minutash, miku im fizikan erdhi në përfundimin se, me një

çikë fat, makina do të na shpinte deri në stacionin hekurudhor pa u bllokuar, nëse ne e shtynim vetë nga mbrapa teposhtë rrugës për ta ndezur.

Sukses! Ia shkelëm si të krisur rrugëve të ngushta, por, kur po i afroshim stacionit, trau i ndalimkalimit qe ulur. Po hynte treni për në Paris. Tjetri vinte pas një ore.

- Jepi, vrap, dil nga nënkalimi matanë, ke për ta kapur.

U hodha me furi drejt stacionit, por ndërmjet meje e trenit kisha një rrethojë pothuaj dy metro të lartë, të mbyllur gjithandej, pa kurrfarë vrime për t'u futur. M'u duk vetja si ai personazhi i një rrëfenje autori tonë klasik, që çelsin e qenefit në dorë e kishte, e megjithatë... Të dalë ku të dalë, thashë me vete, iu ngjita rrethojës dhe rashë matanë. Dy gra më përshëndetën me duartrokkitje. U kapa pas derës së vagonit të fundit dhe shtypa butonin për të hyrë.

Fryma më erdhi në vend, kur po i afroshim Parisit.


Në stacionin Chatelet - një telash tjetër. Nga nguti e hutesa, nuk u kujtova se isha pa biletë. Automati magnetik i kontrollit nuk më hapej. Nuk dilja dot. Mirëpo më ndriti ylli i shpëtimit nga ky siklet - një zezak i gjatë, të cilin iu ngjesha për mbrapa dhe kalova ngjitur me të. Ai u shtang nga habia, por nuk foli. Edhe unë nuk bëj zë kur të tjerët e tjerin muhabetin në telefon.

Më pas punët shkuan fjollë: bëj një dush, ndërrohem dhe mbërrij tamam në kohë te vendi i takimit. Zë vend ndenjuri në foajenë e hotelit, me sytë te dera, dhe rri e vras mendjen: A do ta njoh për fytyrë? Po ai, si do të më njohë?

Befas, një burrë plak i gjatë, me flokë të dendur të thinjur të qethur karé, i veshur me xhakëtë lëkure dhe triko të trashë Aran, erdhi drejt meje: - Zoti Janouh?

Shkuam për kafë. Samuel Beketi porositi dy herë ekspres dyshe.

Folëm e folëm për afro një orë. Me thënë të vërtetën, më shumë fola unë. Ai më kërkoi t'i rrëfej për



mbrëmjen e organizuar në Stokholm, për shfaqjen e Katastrofës, dhe për situatën në Çekosllovakia. E njihje fare pak, interesimi i tij qe vërtet i madh. I fola për Vaclav Havelin, për burgimin e tij, për përvojën me autoritetet, të cilët i dhanë leje për të shkruar në Nju Jork për premierën e njëjës prej pjesëve të tij. Se ç'luante në këtë mes, dardha e kishte bishtin mbrapa, dhe Haveli nuk e pranoi. I rrëfeva sesi njerëzit i luanin pjesët e tij në apartamente private, ia botonin librat me kopje dorëshkrimesh të daktilografiuara. I rrëfeva për Fondacionin Karta 77. Nuk m'i ndante sytë as edhe për një çast, përpinte i përqendruar çdo fjalë, dhe tronditjen ia tradhtonin vetëm duart e mplakura gjithë trur dhe damarë. - Si u lidhe ti me këto punë, - më ndërpreu papritmas.

E kuptova se më kishte marrë për suedez. I shpjegova shkurt përse nuk isha suedez, përse zor se mund të bëhesha i tillë në këtë jetë.

Zumë të flasim për pjesët e tij. E ndjeva sa me zor i punonte kujtesa; për shembull nuk e mbante mend mirë në kishte qenë në Pragë për premierën e pjesës Në pritje të Godosë. M'u dha t'ia kujtoja se edhe e shoja kishte qenë e pranishme atje. Ai e kaloi fjalën tek e sotmja, pjesët po i luheshin në teatrot e Broduejt në Nju Jork, tha, dhe, kishte dëgjuar se edhe do pjesë të Vaclav Havelit po luheshin atje. E pyeta çfarë e kishte frymëzuar për t'ia kushtuar Katastrofën Havelit. U duk sheshit se ra në siklet - gishtërinjtë e gjatë të dorës zunë të trokitnin më shpejt në pllakën e mermertë të tavolinës. - I kam lexuar pjesët e tij. Desha të shpreh përkrahjen time për të, dashamirësinë time, solidaritetin tim...

Biseda jonë ngriu pezull. Nuk desha të zbres në vogëlsira ose ta lodh.

I përmenda Operën për tre grosh të Havelit dhe i thashë se ajo do të shfaqej vitin e ardhshëm në Festivalin Teatror të Parisit. Nga çanta e dorës nxora dorëshkrimin e përkthyer në frengjisht. Beketi e mori, e shfletoi, dhe më pyeti: - A mund ta mbaj për ta kënduar më vonë?

Unë bash këtë doja. Mendimi i Beketit dhe fjala e tij mund të ndihmonte që Hirushja e dashur e Havelit të hynte në botën e madhe. - Si jo, pa tjetër, - i thashë.

- Do t'ju shkruaj, - më tha.

- A mund t'ju bëj disa fotografi, - e pyeta. Më dha një vështrim habie. -

Për t'ia ilustruar gjithë këtë takim Havelit. - Natyrisht, po, po, bëji, - u përgjig me një buzagaz paksa të hutuar, si u ndodh zakonisht të gjithëve në të tilla situata.

Me aparatën tim "Rollej", në madhësi xhepi, i bëra dy foto. Si e lashë aparatën mënjanë, Beketi u këndell në fytyrë, si më parë.

- Nuk po ju mbaj më gjatë. Ju jam mirënjohës për këtë takim dhe për mundësitë që më dhatë t'ju falënderoja drejtpërdrejt.

Beketi më ndërpreu pa fjalë, vetëm me një gjest dore, që mezi binte në sy. Desha të paguaj kafetë. Nuk më la, thirri kamerierin, dhe i dha një kartëmonedhë njëqind-frangshe, të nxjerrë nga xhepi e të mbajtur shuk në dorë qysh më parë. Këmbuem edhe dy tri fjalë në pritje të kamerierit, që nuk po vinte. Pas pak, Beketi thirri një kamerier tjetër dhe me inat i tha "më jep kusurin" në frengjisht. Kamerieri i parë u kthye me kusurin dhe i kërkoi falje. Beketi i numëroi prapë prapë në tabaka dhe i dha diçka për bakshish.

U ngritëm dhe morëm për te dalja. Më dha dorën e ma shtrengoi fort.

- Ju uroj mbarësi në gjithë punët tuaja dhe jepini të falat e mija të përzemërta Vaclav Havelit.

\*\*\*

Atë mbrëmje ia rrëfeva këto një francezeje, dikur aktore teatri.

- Paskeni takuar Beketin? Po e sajoni, më duket. Nuk kam pjekur ndonjë, që të jetë fjalosur sy më sy me Beketin.

Nxora nga xhepi pusullën e ftesës. Ajo e lëçiti gjithë me dyshim dhe më la përshtypjen se donte ta verifikonte nëse qe e shkruar me dorën e tij. Gjatë pjesës tjetër të mbrëmjes me të, një pjesë të admirimit për Beketin ma kaloi mua, me që ia kisha dalë mbanë ta takoja.

Që hyra në botën e teatrit ia quaj për nder Vaclav Havelit. Pa të, kurë nuk do ta kisha takuar Beketin.

Post Scriptum: nga një letër e Vaclav Havelit për mua:

"1.4.1984: Në orën 11 Zdenek Urbanek dhe unë po mendonim për ty si re në bisedë me S.B. (Zdeneku një herë më tha, se më kishte zili vetëm e vetëm për letër, që kisha marrë nga S. B. Unë iu përgjigja: "Shko bëj burg katër vjet me radhë dhe mbase merr një letër të tillë edhe ti!")

(Maj 1984)

Përktheu nga anglishtja Abdurrahim Myftiu



E rrallë

## 'Hulku i Pakistanit' kërkon të dashur, një grua 'të peshave të rënda'

Një peshëngritës me një peshë rreth 450 kilogramë, i njohur si 'Hulku i Pakistanit', është në kërkim të një gruaje, por nuk do të marrë në konsideratë asnjë femër nën peshën 100 kilogramësh. Sipas mediave të huaja, Arbab Khizer Hayat, 27 vjeç, pretendon të ketë



refuzuar deri në 300 nuse të mundshme sepse ato ishin shumë të vogla dhe tani ka rritur kërkimin për një 'të peshave të rënda'.

FOTO E DITES



Kontingjenti shqiptar në Letoni vazhdon kontributin në grup-batalionin e NATO-s, për sigurinë e aleatëve tanë në verilindje të Aleancës.

E jashtëzakonshme

## 'Kërpudha e mjaltit' që peshon 7 500 tonë

Në 'Malet e kaltra' brenda pyllit kombëtar Malheur në lindje të Oregonit gjendet armillaria ostayae, organizmi më i madh, ndryshe i njohur nga shkencëtarët si "Humongous Fungus". Zakonisht njihet si 'Kërpudha e mjaltit' dhe besohet se peshon 7 500 tonë e mund të shkojë deri në 35 mijë tonë. Besohet të jetë organizmi më i vjetër në



botë ku, sipas shkencëtarëve, vlerësohet të jetë nga 2 400 deri në 8 650 vjet e vjetër.

## BARSOLETA E DITËS



Një berber llafazan i thotë një klienti të zakonshëm:  
- A more vesh se më 2 shkurt do të ngordhin të gjitha kafshët e botës dhe më 4 shkurt do të vdesin të gjithë njerëzit?  
- Oh, fatkeqësi!, - thotë klienti, po më 3 shkurt kush do të më ruajë mua?



### Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

#### Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



#### Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min  
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.  
**Regjia:** Jake Kasdan



#### Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min  
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.  
**Regjia:** J.J. Abrams




#### Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe [boxoffice@kinoabc.info](mailto:boxoffice@kinoabc.info), [www.kinoabc.info](http://www.kinoabc.info), [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).

 <p><b>DASHI</b> Dashmirësia e qiellit krijon kushte për një ditë të favorizuar nga fati. Gjithashtu do të keni një efikasitet të jashtëzakonshëm dhe të padiskutueshëm.</p>	 <p><b>DEMI</b> Nuk do të kesh më nevojë për njerëzit që nuk ta ofruan ndihmën në momentet më të vështira.</p>	 <p><b>BINJAKËT</b> Në punë do të jeni ndiheni shumë të lodhur dhe pa energji, prandaj bëni një akt pranimi.</p>	 <p><b>GAFORRJA</b> Sipas nevojës së momentit, ju duhet të përqendrohni te çështja derisa ajo të zgjidhet.</p>	 <p><b>LUANI</b> Qielli i sotëm të do! Fantazia, hijeshia, vendosmëria dhe shpikja do t'ju lejojnë të ndërmerri nisma që mund të kenë implikime të këndshme.</p>	 <p><b>VIRGJËRËSHA</b> Disa gjëra do t'ju grumbullohen dhe do t'ju shkaktojnë ankth, padurim, tërbim. Gjendja juaj emocionale dhe subjektiviteti nuk mund t'ju bëjnë t'i kuptoni pikëpamjet e të tjerëve.</p>
 <p><b>PESHORJA</b> Në fushën e dashurisë do të jeni shumë të lumtur dhe do të keni një intensitet emocional dhe seksual me partnerin.</p>	 <p><b>AKREPI</b> Dhe për ta bërë këtë ju përdorni metodalitetin tuaj falë të cilit çdo detaj i vetëm kontrollohet disa herë dhe çdo aspekt i punës suaj, ndiqet në mënyrën më precize.</p>	 <p><b>SHIGJETARI</b> Në ditën e sotme do të theksohet më shumë popullariteti dhe reputacioni juaj. Takoni të dashurin/ën tuaj, nuk do të pendoheni!</p>	 <p><b>BRICJAPI</b> Janë mendimet tuaja sot që do ta formësojnë fatin tuaj nesër! Besojini gjërat që ju janë thënë nga ata që kujdesen për të mirën tuaj.</p>	 <p><b>UJORI</b> Çdo problem do të jetë më i lehtë për ju. Jeta e përditshme është gjithmonë plot stimul, prandaj bëni disa ndryshime të dobishme që e bëjnë atë më interesante dhe të qetë.</p>	 <p><b>PESHQIT</b> Dita fillon me disa shqetësime të lehta, por do të zbuloni se janë plotësisht të pabazuar! Para se të gjykoni një 'të bardhë' ose 'të zezë', mësohuni të mendoni.</p>



## Rihanna me veshje sportive dhe take me plot shkëlqim



**R**ihanna është pa dyshim mbretëresha kur vjen puna te kombinimi i veshjeve që janë të stileve të ndryshme. Ylli 31-vjeçar është fotografuar nga paparacët në aeroportin "John F. Kennedy" të Nju Jorkut duke shkëlqyer nga koka te


këmbët. Këngëtarja është parë jo vetëm me qaforen e saj shumë të preferuar të "Rafaello & Co" por, gjithashtu, kishte veshur një palë këpucë me take me plot shkëlqim nga Bottega Veneta, që kushtojnë 1 620 dollarë.

## Dua Lipa dy herë e nominuar në 'NME Awards'



**K**ëngëtares shqiptare, siç duket, po i ec shumë mbarë viti 2020, ani se në vitin që lëmë pas nuk ishte shumë aktive. Përsëri shqiptarja ka arritur që me një këngë të zë vend në nominimet e çmimeve më prestigjioze.

Këngëtarja nga Prishtina ka bërë me dije përmes rrjetit social "Instagram" se është nominuar për dy çmime nga 'NME Awards', një garë kjo e mbajtur në Britani që nga viti 1953, e formuar nga "Music Magazine".



## Jennifer Lopez me byzylyk prej 9 milionë dollarësh

**N**ë gati çdo paraqitje publike të saj ajo merr vëmendje. Aktorja dhe këngëtarja e njohur Jennifer Lopez bëri bujë me paraqitjen e saj në çmimet prestigjioze Screen Actors Guild (SAG). Ajo kishte veshur një fustan të gjatë të zi, por ajo që ra në sy ishte

byzylyku në qafë me vlerë mbi nëntë milionë dollarë. Lopez ishte nominuar për punën e saj në rolin e Ramonas në filmin 'Hustlers', më saktësisht për performancën e saj, përkundër se u padit nga vajza në jetën reale që e frymëzoi për rolin e tillë.

## Modeluesja Ashley Graham bëhet nënë

**A**shley Graham dhe bashkëshorti i saj Justin Ervin janë bërë prindër të fëmijës të tyre të parë. "Në orën 6:00 të shtunën jetët tona kanë ndryshuar për të mirë.

Faleminderit për gjithë dashurinë dhe mbështetjen tuaj gjatë kësaj kohe të mrekullueshme!", ka thënë ajo në një postim në "Instagram Story", ku ka njoftuar se është bërë nënë e një djali.





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

# Klubet e Kosovës mbushin 'bateritë' në Shqipëri dhe Turqi

Disa prej klubeve janë zhvendosur në Turqi dhe Shqipëri për t'i vazhduar përgatitjet për sezonin pranveror. Një gjë të tillë e kanë paralajmëruar edhe disa klube të tjera, kurse trajneri Bylbyl Sokoli e vlerëson pozitive përgatitjen jashtë vendit për faktin se fitojnë përvojë nga zhvillimi i ndeshjeve miqësore

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 JANAR - Klubet elitare të Kosovës në futboll vazhdojnë të preferojnë Shqipërinë dhe Turqinë për t'i kryer fazat përgatitore. Tashmë disa prej dymbëdhjetë klubeve të Superligës janë zhvendosur në këto dy vende për t'i mbushur "bateritë" për sezonin pranveror, kurse edhe klubet e tjera kanë paralajmëruar se shumë shpejt do të zhvendosen jashtë Kosovës. Klubi kampion vjeshtor i Superligës, Ballkani, është vendosur në Antalia, ku edhe ka zhvilluar disa ndeshje miqësore. Të martën klubi i drejtuar nga Ismet Munishi, luajti baras 3-3 ndaj Jagiellonias së Polonisë. Skuadra nga Suhareka është duke u përgatitur maksimalisht për pranverë ku synon triumfin në të dy frontet, kampionat dhe Kupë. Në Turqi është vendosur tashmë edhe skuadra e Prishtinës, e cila, sikurse Ballkani, ka ambicie shumë të mëdha për sezonin pranveror. Klubi "bardhekaltër" në Antalia, përveç përgatitjeve, ka planifikuar të zhvillojë edhe disa ndeshje miqësore ku sot (mërkurë) përballë me Ardan (Bullgari), kurse më 26 janar do të luajë me Kolon (Ukrainë), derisa dy ditë më vonë zhvillon miqësoren ndaj skuadrës nga kategoria e dytë e Rusisë, Chertanovo. Kryeqytetasit ndeshjen e fundit e zhvillojnë më 30



janar kundër Ordabasy të Kazakistanit. Përgatitjet në Antalia po i zhvillon edhe pretendentja tjetër për titull, Gjilani. Kjo e fundit e ka zhvilluar një miqësore ndaj Neftchi Kochkor (1-0), kurse sot (e mërkurë) e zhvillon miqësoren e dytë ndaj Yenisey Krasnyarsk nga Rusia. Paralajmërimin se do të vazhdojnë përgatitjet në Turqi i kanë bërë edhe Feronikeli dhe Drita nga Gjilani. Ndërsa Shqipërinë deri tash për përgatitje e kanë zgjedhur Llapi dhe Dukagjini i Klinës. Skuadra që drejtohet nga Tahir Batatina të martën ka zhvilluar miqësoren e radhës ndaj Tërbunit, të cilën e ka fituar me rezultat 2-4. Të papërcaktuara deri më tash dhe që nuk kanë bërë asnjë njoftim zyrtar se

ku do t'i zhvillojnë përgatitjet janë klubet si Trepça '89, Drenica, Vushtrria, Ferizaj dhe Flamurtari. Duhet cekur se të martën një ndeshje miqësore e zhvilluan Trepça '89 dhe Drenica, ku fituese doli skuadra mitovicase (3-2). Trajneri i njohur në Kosovës dhe profesori Bylbyl Sokoli ka thënë se zhvillimi i fazave përgatitore jashtë është një plus i madh për klubet për faktin se do të fitojnë përvojë. "Shumica dërrmuese e klubeve janë duke u përgatitur në Antalia të Turqisë. Kjo do të thotë se buxheti i tyre është më i mirë dhe ky është një plus i madh për skuadrat kosovare. Skuadrat do të marrin përvojë jashtë vendit me anë të ndeshjeve miqësore", ka thënë Sokoli.

## SHKURT

### Liga e femrave nis më 29 shkurt

Stinori pranveror në Ligën e Parë të femrave do të nisë më 29 shkurt, kurse afati kalimtar do të zgjasë deri më 24 shkurt. Duke pasur parasysh ndeshjet që Përfaqësuesja e Kosovës do t'i zhvillojë në fillim të marsit, java e dytë e stinorit do të luhet pas 10 marsit. Po ashtu, në kuadër të përgatitjeve për stinorin pranveror klubet janë të obliguara t'i kryejnë kontrollimet mjekësore në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive sipas orarit të publikuar më herët në faqen zyrtare.

### Ambasadori Minxhozi me drejtuesit e FFK-së bisedojnë për Kupën Mbarëkombëtare

Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe sekretari i Përgjithshëm, Eroll Salihu, e kanë prit në takim ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi. "Gjatë këtij takimi ambasadori Minxhozi përgëzoi drejtuesit e FFK-së për sukseset e arritura deri më tash dhe u shpreh i mahnitur me paraqitjet e Përfaqësues së Kosovës, duke theksuar se është tifoz i 'dardanëve' dhe mburret me sukseset e tyre. Ambasadori shqiptar u interesua edhe për situatën në FFK, derisa u bisedua edhe për nismën e dy federatave për krijimin e Kupës Mbarëkombëtare, garë e cila vlerësohet se do të zgjonte interesim të madh të dashamirët e futbollit dhe do të ndikonte në zhvillim edhe më të hovshëm të futbollit në të dyja vendet. Të dyja palët shprehën interesim për të gjetur edhe forma të ndryshme të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve", thuhet në njoftimin e FFK-së.

### Januzaj largohet nga Spanja, shkon në Itali

Futbollisti shqiptar Adnan Januzaj dëshiron të largohet nga Real Sociedad dhe të transferohet në Itali. Menaxheri i tij, Dirk de Vriese, ka konfirmuar se interesim për anësin shqiptar kanë treguar Milani dhe Roma. Gjatë një prononcimi për Calciomercato.com ai ka dhënë detaje në lidhje me interesimin për Januzajn. "Po, sigurisht", u përgjigj De Vriese në pyetjen nëse Januzaj ka zgjuar interesim nga Serinë A gjatë këtij afati kalimtar të janarit. Në lidhje me bisedimet me Romën ai shtoi: "Nesër do të takohem me Real Sociedadin për ta kuptuar qëndrimin e tij". De Vriese ka konfirmuar interesimin nga Milani për Januzajn. "Po, mund ta konfirmoj. Januzaj do të përgjigjej pozitivisht ndaj një oferte nga Milani", ka shtuar ai.

## Donjeta fiton, Besarti dhe Patrioti humbin

PRISHTINË, 21 JANAR - Donjeta Sadiku e ka nisur në mënyrën më të mirë aventurën e saj në turneun e madh ndërkombëtar "Strandja" në boks. Boksierja nga Kosova mposhti kundërshtaren greke Pita Nikoleta me rezultat 5-0, verdikt ky final nga gjyqtarët e duelit. Donjeta është në rrugë të mirë për të siguruar tjetër medalje në kategorinë 60 kilo-

gramë. Triumfin e Sadikut e ka konfirmuar sekretari i Federatës së Boksit, Latif Demolli, përmes një postimi në "Facebook". Ndryshe nga Donjeta Sadiku, boksieri Besart Pireva tregoi boks të mirë sidomos në tre raundet e parë kundër polakut Lewicki Ryszard, mirëpo në fund pësoi humbje me rezultat 3-2. Në sesionin e dytë të

turneut ndërkombëtar "Strandja" në ring u paraqit 69 kg Patriot Behrami kundër boksierit nga Belgjika, Rachem Mohamed, dhe u zhvillua një meç i fortë, ku gjatë tre raundeve dy boksierët nuk kursyen asgjë, me goditje të njëpasnjëshme dhe boks cilësor dhe në fund, me vendim të gjyqtarëve, fitues u shpall boksieri belg.





## Sfida interesante në Kupën e Kosovës

PRISHTINË, 21 JANAR - Sot (e mërkurë) do të zhvillohen ndeshje shumë interesante në Kupën e Kosovës në konkurrencën e meshkujve. Kjo është xhiroja e katërt dhe skuadrat fituese kualifikohen në "Final 8" të Kupës që do të mbahet nga 11 deri më 15 shkurt.

Ndeshje interesante do të jetë ndërmjet Feronikelit që garon në Superligë dhe Dritës, që luan në Ligë të Parë. Fituesi i këtij dueli do të ballafaqohet në çerekfinale me Bashkimin. Ponte Prizreni do të përballlet me Prishtinën e Re dhe fituesi i këtij ballafaqimi në çerekfinale

do të takohet me Pejën. Trepça - Vushtrria është një tjetër sfidë me interes, ku fituesi i këtij çifti do të takohet me Rahovecin, që për herë të dytë radhazi është organizator i Final 8. Golden Eagle Ylli - Megasport është përballja e fundit në xhiron e katërt. Fituesi në çerekfinale do

të ndeshet me Sigal Prishtinën, që është fituese aktuale e Kupës.

Të mërkurën takohen: Feronikeli-Drita (16:00), Ponte Prizreni-Prishtina e Re (17:00), Trepça-Vushtrria (18:00), Golden Eagle Ylli-Megasport (19:00).



# Shengyli: Liria do të rikthehet në Superligë

PRIZREN, 21 JANAR - Gjërat kanë filluar të vihen në binarë të Liria e Prizrenit. Klubi nga "Përparim Thaqi" tashmë ka konstituuar kryesinë e klubit dhe ka emëruar Skënder Shengylin në krye të stollit të klubit. Tekniku i njohur e di se e pret një punë e vështirë të 'bardhezinjtë', por shprehet i bindur se në fund do të arrijnë t'i realizojnë objektivat që kanë para vetes. "Grumbullimi i parë ishte të martën, ndërkohë që të mërkurën me fillim nga ora 13:00 do të fillojmë edhe zyrtarisht përgatitjet për stinorin pranveror", ka thënë Shengyli. "Jam i vetëdijshëm për gjendjen aktuale në skuadër dhe ka jo pak probleme. Presim që futbollistët t'i marrin pagat e muajve të fundit dhe do të shohim se cila është gjendja me kontrata e futbollistëve. Në pesë ose gjashtë ditët e ardhshme do të shikojmë nga afër fondin e futbollistëve që kemi në dispozicion dhe do të mundohemi të gjejmë zëvendësime adekuatë për futbollistët të cilët tashmë janë larguar", ka deklaruar Shengyli për gazetën "Sheshi".

Tekniku 59-vjeçar nga Prizreni foli edhe për objektivat e klubit, derisa



theksoi se qëllimi kryesor është inkuadrimi në Superligë. "I kam përcjellë ndeshjet e Lirisë në stinorin vjeshtor të kampionatit dhe mund të them se situata është pak e komplikuar. Ne nuk duhet të kthehemi prapa, por duhet të shikojmë vetëm përpara duke lënë prapa edhe problemet. Ne e kemi obligim dhe synim që ta rikthejmë Lirinë në Superligë. Sepse në bazë të traditës, Liria e ka vendin në Superligë", ka shtuar Shengyli. Më pas ai foli edhe për ndeshjen e Kupës së Kosovës, ndërkohë që theksoi se objektivi i vetëm është në Superligë. "Ne kemi një përballje të vështirë në

Kupën e Kosovës përballë Feronikelit. Realisht nuk kemi pretendime të mëdha që të shkojmë më tutje në Kupë, por futbollit nuk i dihet dhe ne nuk do të futemi me flamur të bardhë në këtë ndeshje, ani pse nuk kemi kapacitet që të luftojmë në dy fronte. Përqendrimi ynë maksimal mbetet Superliga", ka përfunduar Shengyli. Liria e mbylli vjeshtën në pozitën e tretë të renditjes tabelore në Ligën e Parë me 26 pikë, dy më pak se liderja, Besa e Pejës. Në kuadër të çerekfinaleve së Kupës së Kosovës do të përballlet me Feronikelin, fitues aktual i këtij kompeticioni.

# Lakersat mposhten nga Bostoni

BOSTON, 21 JANAR - Pothuajse të gjitha ekipet e NBA-së kanë zhvilluar ndeshjet e radhës teksa janë luajtur 14 nga 15 ndeshjet e mundshme. Bostoni triumfoi me rezultat 139-107 ndaj Lakersave, një nga ndeshjet më të dobëta të ekipit kalifornian këtë sezon, edhe pse luajtën të gjithë titullarët (McGee 18 pikë shënuesi më i mirë). Për



Bostonin u dalluan Tatum me 27 pikë si dhe Brown e Walkeri me nga 20 pikë secili. Humbet edhe skuadra e Houstonit (e katërta radhazi), që u mund me rezultat 112-107 nga Oklahoma. Edhe pse Houstoni u shkëput deri në 17 pikë (Westbrook realizoi një triple double me 32 pikë, 11 rebounde e 12 asistime e Hardeni 29 pikë), kjo nuk mjaftoi. Për Oklahomën u dalluan Chris Pauli me 28 pikë e Gallinari me 25 pikë e

13 rebounde. Në Lindje vazhdon të dominojë skuadra e Milwaukee, më e mira aktualisht në NBA. Bucks fitoi 111-98 ndaj Chicagos, me të zakonshmin Antetokounmpo që realizoi një "triple double" (28 pikë, 14 rebounde e 10 asistime). Fiton edhe Utah Jazz, forca e dytë në Perëndim, që mundin 118-88 Indiana (Mitchell 25 pikë), ndërsa kampionët e Toronto mundën 122-117 Atlanta (Powell 27 pikë).

## SHKURT

### Manaj: Pas ofertës së Barçës nuk doja të dëgjoja më tepër

Rei Manaj firmosi për Barcelonën B të hënën për ta zyrtarizuar largimin e tij nga Albacete. Transferimi erdhi për 700 mijë euro, ndërsa klauzola e largimit që iu vendos nga katalanasit ishte 50 milionë euro. Ndërkohë sulmuesi shqiptar është shprehur i lumtur për këtë aventurë të re. Në dëshirat dhe ëndrrat e futbollistit mbetet kalimi dhe debutimi në ekipin e parë, megjithëse tregohet i kujdesshëm dhe i matur me fjalët. "Është një nga ditët më të rëndësishme të jetës sime që po firmos me një klub të madh dhe për mua më i miri në histori. Kur erdhi ky interesim i Barçës nuk doja të dëgjoja asnjë ofertë tjetër. Jam shumë i lumtur që jam këtu. Kam disa objektiva që dua t'i mbaj me veten dhe shpresoj se skuadra të ngjitet në Segunda. Ky është klubi më i rëndësishëm", ka thënë Manaj.

### Chelsea synon transferimin e Cavanit

E ardhmja e sulmuesit të Paris Saint-Germainit, Edison Cavani, vazhdon të jetë e paqartë. Skuadra e Atletico Madridit ka bërë ofertë për shërbimet e tij, por klubi francez nuk ka qenë i kënaqur me ofertën dhe e ka refuzuar menjëherë. Në anën tjetër mediat raportojnë se interesim për Cavanin ka shfaqur edhe Chelsea, ani pse kjo skuadër ende nuk ka bërë ndonjë ofertë zyrtare. 32-vjeçari ka kërkuar të largohet nga "Parc des Princes", pasi e ka humbur vendin e titullarit që po e mban Mauro Icardi.

### 'Chicharito' transferohet te La Galaxy

Javier Hernandez 'Chicharito' edhe zyrtarisht ka kaluar te La Galaxy. Meksikani u largua nga Sevilla, për të kaluar te skuadra amerikane për një shumë që ende nuk është zbuluar. "Chicharito" është shprehur shumë i lumtur me kalimin e tij në MLS, duke e konsideruar si opsionin më të mirë. "Ishte koha e duhur, mundësia më e mirë. Jam shumë i lumtur që iu bashkova një klubi si La Galaxy, mezi pres të fillojë të luajë këtu", ka thënë ai. Kontrata e tij do të skadonte në vitin 2022 te skuadra spanjolle, por që vendosi të kalonte në Amerikë.

### Wernerit shihet si zëvendësues i Suarezit te Barça

Barcelona është gati t'i bëjë ofertë RB Leipzigit për ta transferuar sulmuesin Timo Werner, të cilin e sheh si zëvendësues të Luis Suarezit të lënduar. 23-vjeçari Timo Werner nënshkroi kontratë të re me liderin aktual të Bundesligës në gusht të vitit 2019 dhe ka kontratë në Leipzig deri më 2023. Megjithatë, klubi katalanas është i gatshëm ta tentojë transferimin e futbollistit gjerman, pasi që tani i duhet një qendërsulmues që mund ta zëvendësojë Luis Suarezin, i cili do të mungojë për disa muaj. Interesim për Wernerin kanë shfaqur edhe Liverpooli dhe Chelsea.

### Lewandowski: Me Mullerin për krahe e kam më të lehtë

Robert Lewandowski po konfirmohet edhe në këtë sezon si një nga golashënuesit më të fortë në panoramën e futbollit evropian. Polaku, i cili ka shënuar edhe në ndeshjen e fundit të Bundesligas, ka zbuluar për "Bild" një sekret të vogël: marrëdhënien e mirë që ka në fushën e lojës me Thomas Mullerin. "E kam më të lehtë me Thomasin në krahu tim. Më ndihmon shumë; kompletohem shumë mirë në fushë. Thomas bën disa lëvizje drejt topit ose drejt portës që më lejojnë mua të lëviz më mirë. Ai lëviz shumë dhe kjo më ndihmon. Kur luan Thomasi kemi gjithmonë një lojtar më shumë në zonën e rreptësisë dhe për këtë arsye unë kam më shumë hapësira", ka thënë Lewandowski. "Shpesh kam dy ose tre kundërshtarë që më mbulojnë, por kur është Mulleri duhet të mendojnë edhe për atë. Shpresoj dhe besoj se do të luajmë bashkë më shpesh", ka shtuar sulmuesi polak.

#### REZULTATET

Washington - Detroit	106-100
Atlanta - Toronto	117-122
Brooklyn - Philadelphia	111-117
Charlotte - Indiana	83-106
Cleveland - New York	86-106
Houston - Oklahoma	107-112
Memphis - New Orleans	116-126
Miami - Sacramento	118-113
Milwaukee - Chicago	111-98
Boston - Lakers	139-107
Minnesota - Denver	100-107
Phoenix - San Antonio	118-120
Utah Jazz - Indiana	118-88
Portland - Golden State	129-124





<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>						MODERATORJA DHE MODELJA NË FOTO	NITROGENI	QYTET I MADH NË GJERMANI (pashq.)	AKTORI REXHEPI	KONOP	<b>EPOKA E RE</b>	ZANORE	DY BASHKËTINGËLLORE	AKTORJA DHE KËNGËTARJA ..... GOMEZ	PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA	HUMANISTI BIÇIKEMI
I LËK-UNDSHËM NË QËNDRIME											SHKOLLIM, ARSIMIM AKTORJA E FAMSHME ..... STRIP					
VEÇIM												BITUMI NATYROR ENË PËR TË SKUQUR VAJIN				
AFTËSI E PAGIMIT, AFTËSI E PAGESËS (treg.)													DAFINË LLOJ ËMBËLSIRE			
ENEDA TARIFA								RRALLËSIA (Lat.) ENË PREJ TENEQEJE PËR QUMËSHT								
SHTEG									LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË SHKRIMTARI XHAFOLLI						NANTES FLETË LETRE PËR DUHAN (shq.)	
TOTENHAM						FILLIM I AGIMIT GRILL (sh.shq.)				NJOLLAT RRJETËZA E SYRIT						AI QË PRET DRURË ME LATË
PËLHURË QË PËRDORET PËR TË VESHUR NGA BRENDA RRO-BAT (pashq.)											NITON KËNGËTARJA AMERIKANE ..... BLACK (Shqip.)			ANA LUIS DY BASHKËTINGËLLORE		
<b>EPOKA E RE</b>	KOMANDANTI I NJË ANIJEJE	VENDEË, RRËNJËS	GOTË PREJ BAKRI	ILVA MARE	BASHKËT.	PJESË E KOMPJUTERIT						AKTORJA E SHQUAR XHESIKA PAJISJA PËR DREJTIMIN E VETURËS				
AI QË VRET DIKË NË MËNYRË MIZORE (pashq.)						VLERË E MONEDHËS SË NJË SENDI KUNDREJT ARIT KOPSHI I MADH							LUMË NË SHQIPËRI POLITIKANI IZRAELIT ..... PERES			
EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN					TË HOLLA QË PRODHOHET NË SERI				EMËR MASHKULLI MYSLIMAN ZANORE					DEM, TER SEKT I VEÇANTË I MYSLIMANËVE		
PASIM (Sport)				ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ LUIS .... METËR, ALUMIN				E SHASTISUR LETËR E FORTË NË BIXHOZ								
IDRIZ SEFERI			AKTORJA BUDAKOVA SHINË E TRENIT						ENDE PRINCIPATË ARABE						ZANORE PIKTORI .... VALLA	
BASHKËT.		PJESË E TRUPIT TË NJERËZVE (shq.) ISH FUTBOLLISTI EDVIN .....						"TETOVA" PËRFUNDIM NË SHAH			QILIM I VOGËL QË SHTROHET ANËS VATRËS ALYSSA MILANO					I BUKURI (bised.)
SHKRIMTARI .... ZOLA (shq.)					ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE	MARKË E VESHJEVE SPORTIVE NË DITËN E SOTME					PREZANTUESJA GJONI (shq.) KOMPOZITORI KOCI					
KUMBARË				ARKA BIXHOZ					GRIMCOVA (bised.) PARIA E SHOQËRISË			KYÇ	ZOTËROJ DRAMATURGU DHE SKENARISTI JETON .....			
SHTET NË AZI					KËSHILLTAR LIGJOR PËR DISA VEPRIME PËLHURË PËR TË MBËSHTJELLË FLOKËT (shq.)					FLEGRA MURI I NDËRTUAR ME DËRRASA						
<b>EPOKA E RE</b>	BISHË MALI (fem. - sh.shq.) POLITIKANIA ..... TAHIRI							PJESËTARET E NJË POPULLI TË LASHTË NË EVROPË BASHKËT.							BASHKËT. THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.)	
ELIZABETH TAYLOR			PYLL FUTBOLLIST I NJOHUR PORTUGEZ			JETËDHËNËS PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR E NORMAVE JURIDIKE (shq.)						BASHKËT. LËRE (bised.)		KLINT ISTVUD RITUALE		
ENERGJIK, I SHKATHËT								SHENJË NDERKOMBËTARE PËR KAMION ZULMË			LLOJ VEGLE MUZIKORE KAM DIJENI					DY (turq.)
ZANORE		SHTET FEDERAL NË SHBA OLIVER NEUVILLE								ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË (shq.) ADRIAN KRASNIQI						
TONELATË				KËNGËTARJA .... NDOCI ZANORE				... NOKSHIQI ZANORE				SULM ZANORE				
RRIP I GJERË QË PËRDORET PËR TË MBULUAR MINDERET					TËRËSIA E LËVIZJEVE TË PJESËVE TË FTYRËS											TRAJNERI SHOSHOLLI (shq.)









## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

